

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel: (04)2359-104, Fax: (04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7326 E mërkurë 18 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Komenti Sportiv

Nesër Skënderbeu evropian i Shqipërisë pret Partizanin e Beogradit. Një ndeshje zyrtare, e vlefshme për grupet e Ligës së Europës. Një ndeshje në fakt shumë ...
Vijon në faqen 21

Nga ERVIN BAKU

Skënderbeu-Partizani i Beogradit dhe autogoli i UEFA-s

Opinion Ditës

Shqipëria përpos të tjerave identifikohet edhe për një veçori demografike në raportin global. Ajo ndoshta është shembulli i vetëm i një shteti ...
Vijon në faqen 21

Nga BUJAR NISHANI

Të paktën të mos e fyejmë diasporën!

DOSJA ITALIANE/ KUSHERIRI I ISH-MINISTRIT TE BRENDSHEM: 30 MIJE EURO DO IA ÇOJ SAIMIRIT

PERGJIMET E DROGES: TAHIRI BEN 5 MILIONE EURO NE MUAJ

- Skandali/ Dialogu i Moisi Habilajt me anëtarët e bandës: Saimirit nuk i dalin 20 milionë euro për fushatë
- Ish-ministri i Brendshëm: Habilajt i kam kushërinj të 10-të, bëra gabim që u shita makinën pa verifikuar



«Moisi dice "che ha in più di noi quello". Sabi replica che Saimir ha solo la fama, la passione, ma non crede che abbia più soldi di loro. Moisi ci ha fatto un mese ha fatto minimo 5 milioni di euro. Sabi dice che quello è stato nella campagna elettorale. Moisi dice che a quello non gli bastano ne un campagna elettorale. Moisi dice che per suo nipote bastano 10 mila euro al mese per oggi. aggiunge: "quello ci servirebbe a noi... ma quello è un tipo maligno che dice che non gli interessa che sto un tipo maligno. Sabi gli dice che l'immagina a questioni e non faccia nomi e che l'importante è che non usi il PULU»

(Në foto) Moisi Habilaj, Deputeti i PS, Saimir Tahiri, dje gjatë një konference shtypi. Faksimile e përgjimeve ku përmendet Tahiri

- Edi Rama: Tahirin e kam mbështetur, por përgjegjësia është individuale. Biseda e zbardhur, shokuese
- Lulzim Basha: Të arrestohet! Kryemadhi shkon në selinë e PD: Tahiri është hallka që lidh Ramën me krimin

INTERVISTA

Fatos Nano flet për timonin në politikë: Ja me kë mbaj kontakte

Në faqen 6

UNIVERSITETI

"Luarasi" nis vitin akademik, flasin studentët: E ardhme e sigurt

Në faqen 20

RINISIN APLIKIMET

Lotaria Amerikane, mbi 400 profesione që ju kualifikojnë, kur skadon afati

Në faqen 17

"VIP PAGES"

Robert Aliaj: Në jetë kur nuk ke para, duhet të kesh stil



EMRAT/ Dokumentet për të përfutur këstin e parë

Ish-të përndjekurit, 1 mijë trashëgimtarët që marrin paratë

Dëmshpërblimi/ Ministria e Financave: Fëmijët dhe nipërit të plotësojnë dosjet brenda 3 muajve

Në faqen 9-11

DOSJA "HABILAJ" REAGIMET

Ish-ministri sqaron pozicionin: Dy kriminelë që përdorën emrin tim

Tahiri: Habilajt kushërinj të 10-të, prokuroria le të hetojë për mua

"Gabimi i madh që nuk verifikova kujt ia shita makinën"

Darina Tanushi

Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri, sqaroi dje pozicionin e tij në lidhje me dosjen e Habilajve. Në një konferencë të posaçme për mediat, Tahiri u shpreh dje se dy të arrestuarit i ka kushërinj të dhjetë, por ata kanë keqpërdorur emrin e tij, ashtu siç ndodh rëndom me ministrat në Shqipëri. "Unë jam rritur nga prindërit e mi, e sot rris tim bir, duke besuar tek e vërteta, i bindur se sado e madhe qoftë gënjeshtria dhe abuzimi, e vërteta dhe e drejta janë aty", u shpreh Tahiri në nisje të deklaratës së tij. "Kam mbajtur detyrën e ministrit të Brendshëm për më gjatë se kushdo tjetër para meje, duke mos u dorëzuar kurrë përballë sulmeve të pafundme, nga kundërshtarë që i kisha përballë apo në krah. Kam luftuar çdo ditë, me çdo fuqi timen për të bërë detyrën me drejtësi, si detyrimin tim më të shenjtë përballë tim biri më së pari, familjes sime, përballë miqve e cilidto që më nje, por mbi të gjitha, përballë qytetarëve që më kanë besuar e më kanë zgjedhur e që nga sot pres me padurim të dalë e vërteta në dritën e diellit, si e vetmja rrugë për të pasur besim më të fortë të njëri-tjetri e tek Shqipëria e tim biri dhe e fëmijëve nesër", theksoi ish-ministri. "Sot është një ditë jo e lehtë edhe për mua, në raport me veten dhe moralin tim, familjen time dhe mbi të gjitha tim bir: Po kështu, në raport edhe me njerëzit që më njohin, me kolegët në parlament e politikë, me njerëzit që më kanë besuar e zgjedhur e që besojnë ende tek unë. Dy kriminelë, që janë kushërinjtë e mitë të shkallës së 10, janë arrestuar për trafik droge, e siç u bë publike, pa hezituar të përmendin edhe emrin tim



Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri

ndonjëherë", vijoi më tej deputeti i PS-së. "Kriminelë që përdorin emra politikanësh a ministrash për t'u mburrur me njëri-tjetrin e për dobi të përfitimave të tyre të paligjshme ka pa pafund, e unë nuk jam as i pari e as i fundit. Sigurisht, nuk do doja kurrë të isha në këtë pozitë, pa dashjen time, por unë do kërkoj nga prokuroria, vetë personalisht, me vullnet të lirë e pa përfutur nga asnjë lloj imuniteti par-

lamentar a politik, të hetohet e verifikohet gjithçka lidhur me mua e jo vetëm, me detyrën time e jo vetëm, me familjen time e jo vetëm", nënvizoi Tahiri.

GABIMI

Ish-ministri sqaroi se i vetmi gabim i madh e i vetëm që ka bërë është ai i 4 viteve më parë, kur ka shitur makinën personale. "Unë sigurisht nuk duhet të kisha neglizhuar të verifikoja kujt po ia shisja makinën, e pa-

ELISA SPIROPALI

"Edhe unë si të gjithë jam e shokuar nga çorba e gatuar prej atyre dy të damkosurve nga policia italiane, ku emri i Saimirit hynte e dilte në bisedat e tyre të ndyra. Edhe unë dua ta di të vërtetën për lidhjen e tyre të pretenduar me Saimirin dhe besoj si çdo njeri normal që të vërtetën mund ta mësojmë vetëm nga hetuesit e nga gjykatësit", shkroi dje deputetja e PS-së.

varësisht se në vendin tonë të rrallë janë ata që bëjnë këto verifikime, e të shumtë ata që më kollaj i fshehin a i çojnë në emra të tjerë pasuritë e tyre, unë përsëri mbaj përjegjësi morale për këtë veprim. Përtej kësaj, nuk kam pasur e as kam asnjë raport të çfarëdollojshëm, e aq më pak ndonjë raport të paligjshëm, ndaj nuk kam asnjë përgjegjësi më shumë



VANGJEL DULE

"Sa herë që re të zeza mblidhen mbi z. Rama, ai nxiton t'i hedhë përgjegjësitë mbi bashkëpunëtorë, miq dhe shokë, të sjellë prej tij në pushtet. 'Mea culpa' nuk u dëgjua asnjëherë! Mos erdhni momentit që të drejtojmë përfundimisht gishtin ndaj rrejtës së të keqes, vetë zotit Rama?!", u shpreh dje kreu i PBDNJ-së.

DRITAN ZAGANI

Ish-shëfi i Antidrogës në Fier, Dritan Zagani foli dje nga Zvicra, aty ku ka fituar azil politik. Ai ishte i pari që denoncoi publikisht lidhjen e Saimir Tahirit me klanin e Habilajve në Vlorë. Ai thotë se e di që drejtësia një ditë me apo pa dëshirë do ta bëjë punën e saj për këdo, ndërsa i uron Tahirit "suksese në jetë". "SUKSESE NE JETE Saimir Tahiri... dhe marsh me vete këdo që është si ti... edhe këtë që të shiti de fakto... Se de jure ka kohë që ta ka futur!", shkroi Zagani.

për çdo aktivitet kriminal të kujtdo, qofshin edhe këta kushërinjtë e mitë të 10, që as kanë hezituar të përdorin emrin tim e që shpresoj drejtësia t'i hetojë e dënojë siç u takon atyre e kujtdo tjetër shkel ligjin", theksoi Tahiri. "Nuk kërkoj nga askush të më besojë e aq

më pak të më mbrojnë publikisht, më së pari nga kolegët e partisë sime në parlament ose jo. Në qeveri padyshim, përfshirë kryeministrin. Siç nuk kërkoj nga askush që më njehtë të më besojë kot, për më tepër që politikanë që betohen e përbetohen, ky vend ka parë boll, edhe kur janë kapur me presh në dorë, me filmime e regjistrime, duke vjedhur e duke vrarë", u shpreh Tahiri.

"Unë as jam kjo racë, e as do jem kurrë lloji i politikanit që fshihet pas pushtetit, pas miqësisë me pronarët e medias apo në korridoret e pushtetit. As kam ndërmend të kërkoj apo t'i shtrij dorën ndokujt, në politikë, pushtet, media apo çfarëdolloj, për të kërkuar ndonjë hije a skutë në rrugën që duhet bërë, nga unë vetë i pari, për të nxjerrë të gjithë të vërtetën në dritë. Do pres deri në fund të çdo verifikimi a çdo hetimi e as do rri duarkryq, por do luftoj vetë që çdo e vërtetë të zbardhet deri në fund e drejtësia të thotë fjalën e saj", përfundoi ai duke i kërkuar ndjesë familjes dhe të birit për këtë rrëmujë.

Kryeministri: Shokuese dhe e neveritshme, biseda mes kriminelëve

Rama: Tahiri e kam mbështetur, por përgjegjësia individuale. Presim të vërtetën

Kryeministri Edi Rama ka cilësuar "shokuese dhe të neveritshme", atë çfarë ka dalë me përgjimet ku implikohet ish-ministri Saimir Tahiri. "Duam të vërtetën! Sa më parë! Është e neveritshme dhe shokuese çka ka dalë prej bisedave të dy kriminelëve! Saimir Tahiri e njoh prej vitesh dhe kam pasur vetëm fjalë mbështetjeje e inkurajimi për të, si person me qëllime të mira, aftësi dhe integritet", u shpreh dje



Rama në një status në Facebook", ndërsa ishte në Shkup. "Por - shtoi më tej Rama - Shqipëria dhe shqiptarët sot duan e meritojnë të dinë të vërtetën, vetëm të vërtetën dhe asgjë tjetër përveç të vërtetës. Prandaj

të gjitha organet ligjzbatuese duhet t'i shkojnë deri në fund e pa humbur kohë kësaj historie, për të hedhur dritë të plotë mbi faktet. Vetë qeveria e re është krijuar për të mos falur e as toleruar këdo qoftë që zgjedh rrugën e kriminit në vend të rrugës së Shqipërisë që duam - Me shpirt, punë, mirëqenie. Asnjë rezervë. Asnjë dyshim, lufta jonë me krimin do të vazhdojë në çdo ditë me edhe më shumë forcë. Deri në

fund!", theksoi Rama. Ndërsa në përgjigje të komentuesve në 'FB', ai sqaroi se lidhjet me krimin duhet t'i provojë drejtësia, sepse biseda e dy kriminelëve nuk është provë, por një arsye për të kërkuar që të provohet sa e vërtetë është. "Nuk ekziston në demokraci koncepti i një kabineti të lidhur me krimin, sepse përgjegjësia është individuale dhe as kolektive, as shoqërore, as farefisnore!", sqaroi kryeministri.



Xhensila Kodra

Në dosjen hetimore të autoriteteve italiane me përgjimet e bandës së Habilajve, në të paktën dy raste përmendet edhe emri i ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri. Në një material voluminoz me 416 faqe të një hetimi të nisur nga Gjykata e Katanias në tetor të vitit 2013 për grupin e trafikantëve të arrestuar për 3.5 tonë hashash, përmenden emra trafikantësh, ndër të cilin me pushtet në Shqipëri, data me hyrjedalje nga Shqipëria në Itali dhe anasjelltas, si dhe porositi që ata kryenin për dorëzimin e lëndës narkotike. Po ashtu, në dosje përmenden edhe makinat me të cilat ata lëviznin, apo edhe kodet që pjesëtarët e këtij rrjeti përdornin me njëri-tjetrin. Dosja me përgjimet e plota u publikua dje nga kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha. Të hetuarit e kësaj dosjeje janë Moisi Habilaj, Maridian Sulaj, Fatmir Minaj (të 3 të arrestuar), Nezar Seiti, Armando Sulaj, Tigrans Mezuraj, Sabaudin Çelaj, Florian Habilaj, si dhe shtetasit italianë të arrestuar Antonio Riela, Vincenzo Spampinato, Angelo Busaca, Gianluca Passavanti.



Të arrestuarit në Itali (Në rreth) Moisi Habilaj

Tahiri i kërkoi takim, Llalla e refuzoi



Vetëm 30 minuta pasi kreu i Shërbimit Informativ Shtetëror, Visho Ajazi Likta, ishte larguar nga zyra e prokurorit të përgjithshëm, me të cilin biseduan kokë me kokë, Saimir Tahiri telefonoi Adriatik Llallën për t'i kërkuar takim. Takimi u vendos të zhvillohej në zyrën e kryeprokurorit në orën 12:30 të së premtës. Ora kaloi, por ish-ministri i Brendshëm nuk u pa të hynte në godinën e organit qendror të akuzës. Ish-ministri i Brendshëm, ndërkohë lajmëroi një dalje për mediat nga kryesia e Kuvendit, për të sqaruar pozicionin e tij, pas arrestimit të Moisi Habilajt në Itali. Mësohet se kryeprokurori u largua nga zyra e tij rreth orës 13:00. Në këtë mënyrë, ai bëri të qartë se nuk do ta prishte në takim ish-ministrin e Brendshëm, i cili po akuzohet direkt nga opozita dhe jo vetëm për lidhje me bandën e Habilajve dhe trafikun e drogës. Burime nga zyra e kryeprokurorit sqaruan se takimi nuk mund të zhvillohej për shkak të angazhimeve të zotit Llalla. Po sipas burimeve, me gjasë biseda do të kishte fokus arrestimin e Habilajt në shtetin fqinj. Ndërkaq, kryeprokurori Adriatik Llalla pati dje një takim edhe me kreun e SH-ISH, takim ky që zgjati për rreth 60 minuta dhe në helb kishte arrestimin e

PËRGJIMET/ Byzylykë 8 mijë euro për nënën e gruan e ish-ministrit

"Saimiri në një muaj ka bërë minimumi 5 mln euro"

Habilaj: S'i mjaftojnë as 20 mln në një fushatë elektorale

janë: 72 të atyre në Fier, 20 të Arsenit, 170 mijë lekë heqim dhe këta të shtetit që kemi", thuhet në dosje. Ndërkaq, në një përgjim të kryer në dhjetor të 2013-ës, Moisiu i thotë Sabaudinit se ka blerë dy byzylykë për gruan dhe nënën e Saimirit dhe se kishte paguar 8 mijë euro, pasi kishin edhe nga një diamant. Më tej, Moisiu tregon se për këto kishte edhe nga një certifikatë, që në rast të humbjes apo vjedhjes së tyre, mund të bëhej denoncim dhe u rimburshej. Po ashtu, në dosje thuhet se Moisi Habilaj dhe Sabaudin Çelaj më datë 24 shkurt 2014 kanë shkuar në Sicili me makinën tip "Audi A8" me targë AA003GB në emër të Sajmit Tahirit, për të takuar një person të quajtur Melo, kamionist, i cili do t'u dorëzonte paratë që këta duhet të transportonin për llogaritë të tyre në Shqipëri. Po kjo makinë shfaqet në datën 4 mars 2014, ku Moisi Habilaj dhe Sabaudin Çelaj kanë udhëtuar nga Bari drejt portit të Durrësit.

PËRGJIMET PËR SAIMIR TAHIRIN

Më datë 16 dhjetor të vitit 2013 në bisedën me Moisi Habilajt dhe Sabaudin Çelajt, sipas vlerësimit të prokurorëve dhe gjykatësve italianë, përmendin ministrin e Brendshëm të asaj kohe, Saimir Tahiri. Në bisedën me Moisi Habilajt dhe Sabaudin Çelajt, të cilët flasin për një person me pushtet me emrin "Saimir Tahiri" (deputet i Shqipërisë) njeri i politikës, Moisiu thotë: Çfarë ka më shumë se ne ai?
Sabudini: Ai ka vetëm emrin, famën dhe pozitën, por nuk besoj që ka më shumë para se ata.
Moisiu: Saimiri në një muaj ka bërë minimumi 5 milionë euro.
Sabudini: Të gjitha ato para ai i harxhon në fushatën elektorale.
Moisiu: Atij nuk i mjaftojnë as 20 milionë në një fushatë elektorale.
 Ndërsa, në një tjetër bisedë të po mes Moisi Habilajt dhe Sabaudin Çelajt të bërë më 3 mars 2014 përmendet sërisht Saimir Tahiri. Ata përmendin disa shuma për të cilat i detyrohen, duke aluduar për kushëririn e tij, Saimir Bashkim Tahiri, ministër i Brendshëm në Shqipëri, shkruhet ndër të tjera në dosje.
 "Mendo, vjeçtarë që kemi marrë, kemi 75 mijë që janë automatikisht të caktuara. 30 mijë 'kxhaxhait', 30 mijë duhet t'ia çoj Saimirit, bëjnë 60, 15 anija që na duhet patjetër, bëjnë 75 mijë, plus 100 që

che avesse sbagliato in qualche cosa ... perchè è un pò stronzo ... per lavoro ... penso che è prudente anche lui - HABILAJ: si ... sì ... a Enzo quando gli dici qualcosa ... "guarda che gli devi dire ad Antonio così" ... e le parole che dico io lui glielie ripete."
 Inoltre nel corso dei loro dialoghi riguardanti il conteggio dei debiti con i loro sodali in Albania, l'HABILAJ ed il CELAJ facevano ancora una volta esplicito riferimento ad alcune somme dovute ad un certo Saimir, alludendo probabilmente a suo cugino **Saimir Bashkim**

TAHIRI: Ministro degli Interni della Repubblica di Albania, nonché ad uomini delle istituzioni albanesi, evidentemente loro collusi: HABILAJ: tu pensa ... a parte i debiti che abbiamo ... a parte i debiti che abbiamo preso ... abbiamo 75 mila lek (75.000.000) che sono automaticamente dovute ... 30 dello "zio" ... 30 glieli devo portare a "Saimir" ... fanno 60 ... e 15 della nave ... che ci serve per forza ... sono 75 mila lek ... più 100 che sono ... 72 sono di quello di Fier ... 20 di Arsen ... 170 mila Lek! togliamo anche questi dello Stato ... abbiamo ...
 Da evidenziare come nelle conversazioni fanno ... Tahiri (deputato in Albania) "uomo di nome detto "testa di lampadina" ed ...
 I due parlano di un uomo di potere di nome "Saimir" Tahiri (che ha in più di noi quello" ...
 politica. Moisi dice "che ha in più di noi quello". Saba replica che Saimir ha solo il nome (nel senso la fama, la posizione), ma non crede che abbia più soldi di loro. Moisi calcola che Saimir in un mese ha fatto minimo 5 milioni di euro. Saba dice che quello i soldi lui li perde/lascia nella campagna elettorale. Moisi dice che a quello non gli bastano neanche 20 milioni in un campagna elettorale.

Faksimile e dosjes ku përmendet emri i Saimir Tahirit

Sabudini: Çfarë na bëri ai qelbësirë!
Maridiani: Na prishi çdo gjë... na ka dëmtuar.
Sabudini: Lëre çfarë dëmi...
Maridiani: Po kur e shihja atë punë (i referohet mallit ndr) që përfundoi ashtu... Xhaxha... nuk e di... më vinte keq si të ishte një femijë.
Sabudini: 1 ton e 300 mijë kile ishin.
Maridiani: Më vinte shumë keq sikur të bëhej fjalë për një femijë, e kupton? Që e kapën ata.
Sabudini: Një ton e 300 kile ishin...
Maridiani: Kur e shihja që e merrnin ata qelbësira në kurriz.
PËRGJIMI: MË KËRKOI "SHEFI I MADH"
 Në tetor 2013, Moisi Habilaj (ndodhet në Katanian) bisedoi në telefon me vëllain, Florianin (ndodhet në Shqipëri).
M: Tjetër çfarë thuhet?
F: Asgjë, mbrëmë u nisa nga Tirana dhe sapo kam ardhur në Fier.
M: Pse?
F: Më kërkoi "shefi i madh".
M: Çfarë donte?
F: Asgjë, për këto gjëra.
M: Ah, fole ti vetëm për vetëm me të?
F: Po, më priti në 11:30, taksia që më dërguan dhe paguan ata.
M: Çfarë tha ai?
F: Tha: "çfarë janë këto? Çfarë kanë... si është gjendja? Unë i thashë: Kështu, ashtu (nënkupton që i ka thënë çdo gjë që ka ndodhur).
M: Atëherë?
F: Më tha - Mos u mërzit,

mos e vrit mendjen se është çështje orësh.
M: Ah po duhet t'i thoje që nuk ishte faji ynë, këtë duhet t'i thoje!
F: Po ia thashë, që ne nuk... aspak... më tha: "Ata e bënë kastile, sepse unë, "shefi i madh" i mora në telefon.
M: Edhe ne e kuptuam, për këtë nuk e shqetësuam (shefin e madh).
F: Edhe ne e morëm vesh dhe më tha: "Unë e mora dhe i thashë: Nuk duhet të përzihesh në këto llojra" (punët e shefit).
M: E ka marrë ai në telefon?
F: E mori ky "i madhi" (shefi).
FRIKA PËR KORRIERËT
 Nga përgjimet ka rezultuar se Moisi Habilaj kishte nisur të shqetësohej për faktin se gjërat mund të shkonin keq dhe mund të arrestoheshin, pasi korrierët e tyre ishin arrestuar.
Moisiu: Ermal, ato janë në qytetin e tyre dhe nuk kanë frikë Ermal. Ishte ti ditë kur i thashë që edhe nëse ti përfundon në burg, je në vendin tënd, ndërsa unë jam larg shtëpisë. Makina duhet të hiqet urgjent, ka bërë mjaftueshëm kilometra.
Ermali: Kur do të vijë të marrë makinën?
Moisiu: Shko lër makinën dhe merre makinën.
Moisiu: Po më çmend Sabudini.
Ermali: Do ti ketë thënë Limosi.
Moisiu: Më shkruan hajde tek marketi. Ku është?

Ermali: Do t'ia ketë thënë Limosi.
Moisiu: Por çfarë do t'i ketë thënë?
FRIKA NGA VDEKJA
 Në makinë është regjistruar një tjetër bisedë mes dy shokëve të Habilajt, pjesë të bandës së drogës, Sabaudin Çelaj dhe Meridian Sulaj. Në komunikime vihen re pseudonimet që ata përdornin për mbërritjen e drogës në destinacion, duke përdorur fjalën "makina" apo "puna". Ndërkohë që në përgjimin e zbardhur përmendet një tjetër pseudonim, "flokët" që nënkuptojnë policinë, të cilët kanë rrezikuar jetën dhe punën e tyre. Në fjalët e Meridianit thuhet se ai ka frikë për jetën e vet dhe i lutet Zotit për ta shpëtuar.
Meridiani: Kur erdhi "makina", unë shkova t'i takoja, "makina" sapo kishte mbërritur.
Sabudini: "Makina" erdhi natën apo ditën?
Meridiani: Natën, natën dhe më tha kështu-kështu e lamë "punën", lamë "makinën" në garazh, e mbyllëm dhe ti ik, sepse më duket se... dhe ne ikëm kështu, sepse ishin "flokët" (nënkupton policinë). Dreqi e mori... dhe nuk jemi të sigurt që do të jemi nesër... dhe unë iu drejtova Zotit: O Zot, o Zot, o Zot, o Zot i madh pse kaq keq puna? O Zot, o Zot i madh. Nuk kam mundur të fle, pastaj u ktheva ditën e nesërme. Të nesërmen në 11:00, siç e kishim lënë, mbërritëm aty dhe ishte gjithçka... (regjistruam nëshpërt).

SITUATA E RENDIT OPOZITA

Opozita nis sot në orën 11:00 aksionin kundër qeverisë, Kryemadhi në zyren e kreut të PD

Basha: Të arrestohet Tahiri! Fakte tronditëse për ministra të tjerë

"Përgjimet e trafikantëve, Rama bleu votat"

Valentina Madani

Kreut i opozitës, Lulzim Basha, kërkoi dje arrestimin e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri, duke paralajmëruar publikimin e fakteve që vërtetojnë lidhjet e tij me kushëririn Moisi Habilaj, që u kap të hënën në Itali për trafik droge. Para mediave ai njoftoi mbledhjen e tryezës së opozitës paraditen e sotme në orën 11:00 nga ku do të dillet me një qëndrim të përbashkët kundër lidhjeve të pushtetarëve të majtë me krimin e organizuar. Tryezës së sotme pritet t'i bashkohet edhe LSI-ja dhe Monika Kryemadhi, e cila mbremë bashkë me kreun e deputetëve të LSI-së, Petrit Vasili zhvilluan një takim rreth një orë me z.Basha në selinë e PD-së për aksionin e ri opozitar kundër krimit dhe lidhjeve të tij me pushtetin. Saimir Tahiri është një nga "peshqit e mëdhenj" dhe se Edi Rama e shiti atë për të mbrojtur sipas Bashës, lëkurën e tij. Në daljen nga selia e PD-së, Basha tha se trafikantët e drogës konfirmuan skemën e blerjes së zgjedhjeve, ndërsa paralajmëroi se të tjera fakte do të dalin në ditët në vijim për ministra të tjerë, pa dhënë detaje më shumë për këtë. "Pyetja që sot shpëtoj në emër të opozitës dhe në emër të çdo shqiptari të djathtë apo të majtë, është se çfarë pret Edi Rama t'i vërë prangat, ta arrestojë e ta ekstradojë, në mos ta gjykojë këtu në Shqipëri, Saimir Tahirin, si një ndër kapitenët kryesorë të trafikut të drogës në 4 vitet e kaluara? Natyrisht, nuk pres përgjigje prej Edi Ramës. Ai e ka mbrojtur Saimir Tahirin këto 4 vite, edhe pse e ka ditur se ai është protektor dhe përfutues i drejtpërdrejtë i trafikut të drogës, përmes bandës Habilaj dhe bandave të tjera të krimit të organizuar. Edi Rama e ka bërë këtë me vetëdije të plotë, sepse paratë e drogës dhe muskuli kriminal i bandave është



përdorur nga Edi Rama bashkë me Saimir Tahirin gjatë zgjedhjeve të 2015-ës dhe në veçanti në zgjedhjet e 2017-ës", deklaroi z.Basha. Kreu i PD-së vuri në dukje se shqiptarët kanë sot dy rrugë, "o të durojnë realitetin që po u imponohet, ose të ngrihen e të kërkojnë të drejtën legjitime për të mos u qeverisur as nga bandat, as nga ministrat, as nga kryeministri i bërë njësh me ta". Sipas tij: "Është ora e vendimeve të mëdha. Por sot është

të dita që Saimir Tahiri të arrestohet dhe procesi gjyqësor ndaj tij të nisë pa vonës. Faktet janë publike, provat janë në tavolinën e Edi Ramës dhe me siguri do të bëhen publike në orët apo ditët në vijim", deklaroi kreut i PD-së. Basha akuzoi se, "provat e hetimit tregojnë se narko-trafikanët kanë kontribuar miliona euro në fushatën elektorale të Edi Ramës". "Provat e hetimit tregojnë se grupi narko-trafikanit, i drejtuar nga Moisi

AKUZA

Në daljen nga selia e PD-së, z.Basha tha se trafikantët e drogës konfirmuan skemën e blerjes së zgjedhjeve, ndërsa paralajmëroi se të tjera fakte do të dalin në ditët në vijim për ministra të tjerë, pa dhënë detaje më shumë për këtë.

Habilaj, kushëri i Saimir Tahirit, i ka paguar shuma maramendëse në dorë Saimir Tahirit, si dhe ka përdorur për trafik droge 'Audi'-n e Saimir Tahirit. PD e ka denoncuar 1400 herë Tahirin për lidhjet e tij me trafikun e drogës. Sa herë dilnin në dritë fakte për lidhjet e Tahirit me bandat, Edi Rama e ka mbrojtur Tahirin dhe e ka quajtur bashkëpunëtorin më të suksesshëm. Sot, Edi Rama e shiti Saimir Tahirin vetëm për të shpëtuar lëkurën e tij. Tahiri është një nga 'peshqit e mëdhenj'. Gjithçka është bërë me dijeninë dhe bekimin e Edi Ramës për të përfutur



paratë e Habilajve", theksoi Basha. Kreu i PD-së shtoi se, "këto janë fakte tronditëse dhe prova që tregojnë skemën se si Edi Rama ka blerë votën dhe ka dhunuar zgjedhjet. Me Edi Ramën në krye, qeveria do të vazhdojë të jetë karteli kryesor i krimit të organizuar dhe drogës në Shqipëri", tha Basha, i cili e mbylli deklaratën e tij duke njoftuar se nesër do të mbahet një tryezë e spektarit opozitar, ku sipas tij, do të merren "vendime të mëdha". Më herët kreut i PD-së, Lulzim Basha, i bëri thirrje prokurorit të përgjithshëm të mos takohet me atë, që ai e quan "të dyshuarin" Saimir Tahiri. Sipas Bashës, faktet dhe provat e lidhjes së Edi Ramës dhe Saimir Tahirit me mafien e drogës janë para syve të çdo shqiptari.



Banda e Habilajve, Noka: Prokuroria të hetojë Tahirin

Akuzave ndaj ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri u është bashkuar edhe deputeti Flamur Noka. "30 mijë euro t'i çohen Tahirit - thotë në përgjime trafikanti i arrestuar", deklaroi z.Noka. Për këtë, ai iu referua të dhënave të publikuara në mediat italiane. Deputeti demokrat shtoi se, "prokuroria nuk duhet të flejë gjumë, pasi këto janë akuzat shumë të rënda. 30 mijë euro t'i çohen Tahirit - thotë në përgjime kushëririn trafikant i arrestuar: Isha me Tahirin, Çakon, Konin e Kulen kur doli në konferencë Berisha - thotë ministrja Nikolla, ndërkohë që AA 003 GB deklaroi se nga Berisha e mësoi për rektorin e kërcënuar... Prokuroria nuk duhet të flejë gjumë! Janë akuzat shumë të forta ndaj AA 003 GB. E para, për trafik lëndësh narkotike. E dyta, që ka të bëjë me rastin 'Shullazi'. Deklaratë e gënjeshtërt nën betim... Sikur një qytetar të bënte këto dy vepra, a do ishte pas hekurave sot? Po AA 003 GB, pse jo?", shpreh ish-ministri i Rendit.

"Tahiri", të gjitha denoncimet e ish-kryeministrit

Përgjimet, Berisha: I sigurt, arresti ndërkombëtar i Tahirit



"Saje qorri provohet anëtar i bandës, merrte nga Habilaj 30 mijë euro për çdo rrugë transporti droge që bëhej me

skafin e tij! Miq, përgjimet e partnerëve italianë, konfirmojnë përfshirjen e Tahirit në trafikun e drogës që bë-

PROVAT

"Saje qorri provohet anëtar i bandës, merrte nga Habilaj 30 mijë euro për çdo rrugë transporti droge që bëhej me skafin e tij! Përgjimet e partnerëve italianë konfirmojnë përfshirjen e Tahirit në trafikun e drogës" shkruan Berisha.

nin tezakët e tij Habilaj" shkruan ish-kryeministri Sali Berisha në "Facebook".



Darina Tanushi

Kryetarja e LSI-së: Situata e krimit, më e rënda që ka përjetuar vendi

Monika Kryemadhi: LSI është pjesë e frontit kundër bandave, mbështes Bashën

"Tahiri është një nga hallkat që lidh Edi Ramën me krimin"

shpalli dje vendimin për të qenë pjesë e frontit të qytetarëve të bashkuar kundër bandave dhe krimit. "Krimi është ulur këmbëkryq në Shqipëri. Situata është nga më të rëndat që ka përjetuar vendi. Çdo qytetar, iri dhe re, burrë, grua, ndihen më të rrezikuar se kurrë në vendin e tyre. Shteti i kriminalizuar i kryeministrit ka kompromentuar shumë rëndë edhe rolin e policisë dhe politikës", tha dje në një konferencë shtypi Monika Kryemadhi. "Përpara këtij momenti shumë të vështirë të gjithë qytetarët janë bashkë dhe nuk ka më asnjë dallim mes tyre, pasi të gjithë janë të rrezikuar. LSI është pjesë e frontit të qytetarëve të bashkuar kundër bandave dhe krimit dhe do t'i shërbejë deri në fund vullnetit për një Shqipëri pa kriminelë në rrugë dhe në pushtet", deklaroi



ajo. Sipas kryetares së LSI-së, "Saimir Tahiri është një nga hallkat që lidh Edi Ramën me krimin, por ka edhe shumë hallka të tjera, që janë ende aty e që i drejton Edi Rama. Janë hallkat e krimit e trafikantëve, por edhe të oligarkëve, që me bekimin e Edi Ramës po pasurojnë paratë e krimit të organizuar". Ajo shprehu hapur bashkimin në një front edhe me Partinë Demokratike. "Mund të ketë pika që ndajnë LSI me

Partinë Demokratike dhe partitë e tjera, por çështja që na bashkon në një front të përbashkët kundër krimit dhe bandave është më e fortë se çdo ndasi mes nesh. Bashkëpunimi politik është një detyrë që na e kanë dhënë qytetarët, është vullneti ynë dhe ne do e çojmë deri në fund dhe pa kompromis misionin tonë. Këtë do ta bëjmë në emër të së ardhmes së fëmijëve, për të cilët vendi ynë duhet të jetë një vend i sigurt dhe i dashur", theksoi kryetarja e LSI-së. "Atdheu ynë i përbashkët është më i rrezikuar se kurrë dhe koha nuk pret. Të mbledhemi të gjithë së bashku kundër kësaj të keqeje shumë të madhe që ka gllabëruar Shqipërinë. Mbështes qëndrimin dhe propozimin e kryetarit të PD, z. Lulzim Basha për tryezë të gjerë politike që do të përgjigjet me një aksion inten-

siv dhe pa kompromis në luftën ndaj bandave dhe krimit në pushtet", u shpreh dje Kryemadhi. Edhe më herët, Kryemadhi shkroi në "Facebook" se Rama është përgjegjësi kryesor për inkriminimin e policisë dhe politikës. "I bëj thirrje prokurorisë të nisë urgjent hetimet për ish-ministrin e Brendshëm dhe lidhjet e tij me kriminalitetin dhe të mos ulet në takime spontane me të kërkuarit e drejtësisë. Sikundër kam bindjen se Tahiri është thjesht i përdorur i radhës nga Edi Rama, që pasi i shfrytëzoi bashkëpunëtorët e tij për lidhjen dhe shfrytëzimin e bandave për të blerë votat dhe kërcënuar zgjedhësit kundërshtarët e tij politikë, sot i flak tuje, sepse nuk i duhen më", shkroi Kryemadhi. Nga ana e tij, edhe kreui grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili duke akuzuar

kryeministrin Edi Rama u shpreh dje: "Kryeministri i drogës nuk i lan dot duart si ponc pilati. Gjithçka kriminale që përmbysi me drogë dhe krim Shqipërinë është vepër e kryeministrit. Është informuar kryeministri nga shumë drejtime, qofshin vende mike dhe aleate, si edhe shërbime partnere për drogën dhe ministrin tutor të saj, me të cilat kriminalizuan në çdo qelizë sigurinë kombëtare dhe të çdo qytetari dhe ka bërë me qëllim të qartë veshin e shurdhëth, sepse ishte njësh me krimin. Nuk i lan dot duart ponc pilati kryeministër, duke shitur ish-ministrin shërbëtor të drogës dhe krimit", u shpreh dje Vasili. "Është ai, kryeministri, fajtor dhe drejtësia s'mund të vonojë më asnjë sekondë, pasi ajo ka një përgjegjësi madhore përpara vendit", përfundoi Vasili.

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi deklaroi dje se Saimir Tahiri është veç një hallkë që e lidh Edi Ramën me krimin. Ndaj LSI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Njoftim për shprehjen e interesit për vendet vakante të 4 këshilltarëve juridikë dhe 2 këshilltarëve ekonomikë pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë

Institucioni i Komisionerëve Publikë, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", dhe vendimit të Kuvendit nr. 94/2017, shpall vendet vakante për 4 (katër) këshilltarë ligjorë dhe 2 (dy) këshilltarë ekonomikë.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data **6 nëntor deri më 10 nëntor 2017**, në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 12:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Pallati i Kongreseve, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 nëntor 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatim e lëshuar nga institucioni përkatës postar. Institucioni i Komisionerëve Publikë do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 6 nëntor deri më 10 nëntor 2017 në adresën info@ikp.al. Institucioni i Komisionerëve Publikë konfirmim nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim (CV), përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumenteve të noterizuara ose të njësuara nga organi përkatës, që vërtetojnë kriteret e parashikuara në nenin 22, pika 3 (për këshilltarët ligjorë), pika 4 (për këshilltarët ekonomikë) si dhe vetëdeklarim për kriterin e parashikuar nga gërma "e", pika 1 e nenit 6 të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuara me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 22, pika 3 (për këshilltarët ligjorë), pika 4 (për këshilltarët ekonomikë) si dhe gërma "e", pika 1 e nenit 6 të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Njoftim për shprehjen e interesit për vendin vakant të 1 kancelari pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë

Institucioni i Komisionerëve Publikë, bazuar në ligjin nr.84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", dhe vendimit të Kuvendit nr.94/2017, shpall vendin vakant për 1 (një) kancelar.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data **6 nëntor deri më 10 nëntor 2017**, në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 12:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Pallati i Kongreseve, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 nëntor 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatim e lëshuar nga institucioni përkatës postar. Institucioni i Komisionerëve Publikë do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 6 nëntor deri më 10 nëntor 2017 në adresën info@ikp.al. Institucioni i Komisionerëve Publikë konfirmim nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve që vërtetojnë plotësimin e kriterëve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim (CV), përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumenteve të noterizuara ose të njësuara nga organi përkatës, dhe vetëdeklarim që vërtetojnë kriteret e mëposhtme:
 - a) të jetë shtetas shqiptar;
 - b) ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi ose në shkencë ekonomike me diplomë "Master i shkencave" në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi ose në shkencë ekonomike jashtë vendit dhe ka marrë një diplomë të njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave, të parashikuara me ligji;
 - c) ka pasur një përvojë pune në nivel menaxherial dhe drejtues, jo më pak se 8 (tetë) vjet;
 - d) ndaj tij të mos të ketë nisur një hetim penal, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
 - e) të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze;
 - f) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislatcionit, në momentin e aplikimit;
 - g) nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike ose nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit.
 - h) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit "Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish-shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" (vetëdeklarim).

Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike, nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuara me origjinalin, që vërtetojnë plotësimin e kriterëve të mësipërme.

SITUATA POLITIKE INTERVISTA

Ish-kryeministri socialist: Maxhoranca e opozita të komunikojnë për integrimin

Fatos Nano: "Timoni" ka ngelur simbolikë e lundëtarëve klasikë

"Mbaj kontakte me aktorët e duhur të skenës politike shqiptare"

Ish-kryeministri socialist Fatos Nano ka zburur një gjendje të ndaj kryeministrit Edi Rama, por një mesazh gjithësi e thotë për të. "Timoni ka ngelur një simbolikë e lundëtarëve klasikë dhe besoj se pavarësisht nga butonat e komandimit, drejtimi nuk është dhe nuk mund të jetë më një prerogativë e një personi, por sidoqoftë çdo ekip ka drejtuesin e vet, i cili duhet të kultivojë në radhë të parë të vetja besimin se është i pari midis të barabartëve dhe jo i ndryshëm prej tyre", deklaroi dje, ish-kryeministri, në një intervistë për Klan Plus.

Kemi një Shqipëri më të mirë tani, zot Nano?

Kemi një Shqipëri më ndryshe, më afër rrjedhave bashkëkohore të zhvillimit në shumë aspekte, por me shumë pabarazi gjë që ka nxjerrë në pah edhe se sa larg parametrevë dhe standardeve të botës së qytetarëve në të cilën jemi ofruar për t'u bërë pjesë, jemi. Dhe sigurisht në qoftë se do të ndërmerrja në këto vitet e pleqërisë time ndonjë iniciativë mediatike, nuk do të kisha të njëjtat dimensionet programore midis telenovelave dhe reality shou-tit si ai që ka klani sot.

Do kishin shqiptarët një timonier më të mirë?

Në kohët moderne, çështja e timonit është digitalizuar që do të thotë timoni ka ngelur një simbolikë e lundëtarëve klasikë dhe besoj se pavarësisht nga butonat e komandimit, drejtimi nuk është dhe nuk mund të jetë më një prerogativë e një personi, por sidoqoftë çdo ekip ka drejtuesin e vet, i cili duhet të kultivojë në radhë të parë të vetja besimin se është i pari midis të barabartëve dhe jo i ndryshëm prej tyre.

Zoti Berisha lu ka dhënë një përgjigje atyre që kërkuan rikthimin në krye të PD-së. Kemi ju një përgjigje për ata që ju mbështetën më për shumë vite, ju adhurojnë për politikën tuaj për vendosjen e rendit në Shqipëri?

Unë jam shumë i vëmendshëm ndaj shqetësimeve të publikut dhe ndaj çdo zhvillimi problematik ose negativ në vend. Nuk besoj se rikthimi, ose kopjimi mekanik ose trans-



platimi mekanik i situatave të së kaluarës në të tashmen do të ishte zgjidhja për çdo gjë. Natyrisht ka shumë nevojë për shkëmbime përvojash, ka gjithnjë një nevojë të pa ezarruar dhe të pa kultivuar, për fat të keq, midis këmbimit të ekspertencës dhe komunikimit edhe të institucionizuar midis drejtuesve politikë, që për fat të mirë janë gjallë, të kreyt periudhës së zhvillimit të Shqipërisë në demokraci. Unë personalisht jam në komunikimin e duhur me aktorët e duhur të skenës politike shqiptare dhe për këtë arsye nuk jam kaq nostalgjik sa pyetja që ju thatë dhe besoj se, për sa më takon mua, ndikimi është pozitiv dhe i dukshëm në disa aspekte në përmirësimin e situatës.

Shqipëria evropiane e nisi këtë rrugë, por si duket po përsëritet i njëjti refren, lufta ndaj krimit, ndaj kultivimit të drogës. Si është e mundur, kjo Shqipëri e vitit 2017 ka të njëjtat probleme?

Nuk besoj se mund ta fotokopjonim realitetin në të njëjtën mënyrë, sepse në rast se devijimet nga ligji, aktivitetet e paligjshme nga informalleti të krimi i organizuar

janë shumë më të vjetra se sa institucionet e shteteve të së drejtës, ato në kohë të caktuara marrin dimensionet e tyre. Ndërkaq unë do t'i rikthehem çështjes se për gjithçka zinxhirët e kriminalitetit të paktën janë globalizuar. Në asnjë rast nuk ndodh që krimi të lindë e konsumohet brenda territoreve të ngushta. Trafiqet ndërkombëtare janë prova më e lexueshme për këtë gjë dhe është bërë fakt i ditës, ku edhe grupet që bllokohen janë gjithnjë e më shumë multinationale dhe nuk po flasim kush zë peshën më të madhe, se nuk them që shqiptarët dallohen për kampionë të së keqes siç na akuzojnë. Ndërkohë unë dua të theksoj se në marrëdhënie me Evropën nuk janë këto gjëra që dominojnë dhe nuk është e dobishme që ndjeshmërinë që krijon media të publiku të dominojnë fenomene negative në raport me shumë procese të reja zhvillimi që po forcojnë partneritet dhe besimin reciprok me institucionet dhe qeveritë e vendeve anëtare të BE-së. Më në fund ngelet pyetja të cilës duhet t'i përgjigjemi në mënyrë krijuese e dinamike se në cilën

Evropë të bashkuar do integrohemi, në atë që ka qenë, në këtë që është apo në atë që as drejtuesit e institucioneve të Evropës së bashkuar nuk e dinë tamam se si do të jetë? Dhe me këtë nuk dua të le asnjë ekuivok nëse është i drejtë procesi i integritimit ose jo, por nga klasa politike, nga drejtuesit e institucioneve shqiptare, e them klasa politike, sepse në raport me integrimin evropian është krim ende i pandëshkuar të flasësh në gjuhë të ndryshme kombëtare për integrimin. Pra, autoritetet vendase të max-



horancës apo opozitës duhet të krijojnë një komunikim përmbajtësor, të zhërvjellët dhe proaktiv me autoritetet evropiane që udhëheqin edhe proceset e zgjerimit, edhe të integritimit për të bashkëpunuar në momentin e duhur ndaj ndryshimeve që u imponohen vendeve aspir-

ante nga vetë reforma e institucioneve të BE-së.

Keni ndonjë parashikim se kur Shqipëria do të jetë anëtare e BE-së?

Kur të kemi një përgjigje më të saktë për pyetjen në cilën Evropë do të integrohemi, do të kem edhe një për afatet.



"INTEGRATED ENERGY B.V. SPV" shpk

FTESË PËR SHPREHJE INTERESI

Qeveria shqiptare, përmes një tenderi të hapur ndërkombëtar, ka shpallur fitues kompaninë "INTEGRATED ENERGY B.V. SPV" shpk me objekt dhënie me koncesion të formës BOOT (Build, Own, Operate dhe Transfer) për ndërtim landfilli, incineratori dhe rehabilitim i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje koncesionare është menaxhimi i Integruar i mbetjeve në Qarkun e Tiranës. Zona e propozuar për ndërtim e impiantit të ri të MNU-ve dhe venddepozitimit do të shtrihet në jug dhe lindje të zonës së venddepozitimit ekzistues (Sharre) të qytetit të Tiranës.

"INTEGRATED ENERGY B.V. SPV" Sh.P.K (ne cilësimin e koncesionarit), fton kompanitë e interesuara vendase dhe të huaja të paraqesin kërkesën për shprehje interesi për fazën e parakualifikimit në procedurën konkurruese përgjigjëse (Shërbime Konsultance) për shërbim mbikqyrje (Supervizim), për punimet e ndërtimit në zbatim të kontratës koncesionare me objekt "Për ndërtim landfilli, incineratori dhe rehabilitim i venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike"

DUKUMENTAT E KËRKUARA PËR FAZËN E PARAKUALIFIKIMIT

- Kërkesa për shprehje interesi e kandidatit
- CV të kompanisë
- Ekstrakt i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.
- Licensa profesionale për "Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi", e vlefshme, ku të përshihen kategoritë të cilat lidhen me punimet objekt i kontratës koncesionare, (sipas modelit të lëshuar nga MPPT)
- Përvijë e suksesshme në projekte të ngjashme, në 5 vitet e fundit. Sfondi i kompanisë në aktivitetet të ngjashme si supervizimi dhe kolaudim, incineratorëve etj do të konsiderohet si të favorshme në vlerësim.
- Xhironja mesatare e tre viteve të fundit (definuar si fatumit për punët në progres dhe të përfunduara) të jete jo me i vogël se Euro 250,000 (dyqind e pesëdhjetë) mijë.
- Bilancet e dy viteve të fundit.
- Certifikatat e cilësisë së kompanisë (ISO)
- Tabela e organizimit të shoqërisë (organizograma)
- Personeli kryesor i propozuar për këtë projekt (i paraqitur në formë organizogrami) dhe kualifikimet e stafit kryesor të propozuar.

"INTEGRATED ENERGY B.V. SPV" Sh.P.K, do të shqyrtojë dokumentat e dorëzuara nga Kandidatët, dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentat e paraqitura nga kandidatët. Kandidatët, që i plotësojnë kriteret e kualifikimit, do të njoftohen për të paraqitur propozimin teknik dhe propozimi ekonomik.

Kompanitë e interesuara duhet të dorëzojnë kërkesën origjinale dhe dokumentacionin përkatës, të futur në një zarf jo transparent, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e kandidatit.

Paraqitja e kërkesave për shprehje interesi duhet të bëhet brenda datës : 27.10.2017 ora 16:00 në adresën e email: info@iebv.al

Asnjë ofertë e paraqitur pas kësaj afati nuk do të pranohet.

"INTEGRATED ENERGY B.V. SPV" Sh.P.K
Adresa: Rr. Dervish Hima, Hyrja Nr. 1, Apartamenti 7/1
Të dhëna të kontaktit cel. 0688014284 , info@iebv.al

Personi i kontaktit : Zj. Denisa Tollkuçi
Email: info@iebv.al

Koordinatori i OKB: Bashkitë të fitojnë më shumë besimin e qytetarëve

Perceptimi i qytetarëve për korrupsionin në nivelin e qeverisjes vendore mbetet i lartë, por kur ata pyeten mbi përvojat e tyre personale, raportohet një vlerësim më i ulët. Këto janë disa nga gjetjet e një studimi "Hartzëzimi i qeverisjes vendore në Shqipëri", i prezantuar dje nga PNUD dhe partnerët e tij në projektin "STAR 2". "Është e sigurt se besimi tek institucionet nuk ekziston, nëse njerëzit nuk kanë perceptime pozitive. Institucionet shqiptare duhet të fitojnë më tepër besim nga qytetarët e tyre", tha Brian J. Williams, koordinator i përhershëm i Kombeve të Bashkuara.



Presidenti viziton shoqatën humanitare "Strehë e shpresë"

Meta: Pa luftuar varfërinë, nuk garantojmë dot drejtësi sociale

Presidenti i Republikës, Ilir Meta vizitoi dje mjediset e shoqatës humanitare "Strehë dhe Shpresë" në Tiranë me rastin e 17 tetorit, Ditës Ndërkombëtare kundër Varfërisë. Presidenti Meta u njoh nga afër me kushtet që ofron si dhe me problematikat që ka kjo qendër, që prej 20 vitesh strehon dhe përkujdeset për rreth 30 të moshuar rezidentë, si edhe funksionin si qendër ditore për më shumë se 35 fëmijë jetimë e me probleme social-ekonomike të komunitetit rom, të cilëve u ofrohet një program mësimor-edukues si edhe ushqim falas. "Lufta kundër varfërisë është një luftë edhe për të garantuar të drejtat dhe dinjitetin e çdo qytetari, të çdo të moshuari, por edhe të çdo fëmije. Pa luftuar varfërinë, nuk garantojmë dot drejtësinë sociale që meriton një shoqëri e standardeve evropiane. Pa luftuar varfërinë, nuk luftojmë dot një nga burimet kryesore të kriminalitetit dhe të sigurisë publike dhe për këtë, armët më efikase janë një rritje ekonomike më e madhe, por jo vetëm kaq", - theksoi presidenti.




PD-LSI: Masë disiplinore për Bushatin. PS, Ruçit: Të rishikohet rregullorja

Sherr tek 'Integrimit', Pollo: Rrugaq Bushati: Kërko ndjesë, 'Salikuq'

Kreu i komisionit: Mbylle gojën! Ministri: Ndotës

Valentina Madani

Mbledhja e djeshme e Komisionit parlamentar për Integrimin degradoi deri në fyerje personale mes ministrit Ditmir Bushati dhe kreut të komisionit, Genc Pollo. Një seancë dëgjimore me ministrin përfundoi me sherr mes tij dhe Pollos. Kreu i komisionit i quajti komentet e Bushatit si prej një rrugaçi, ndërkohë që ministri u largua nga mbledhja me kërkesën që t'i kërkojë ndjesë për fjalorin. Para se të largohej nga mbledhja, Bushati tha se nuk lejoi as Pollon dhe as Saliun ta fyejnë. Pas këtij momenti, deputetët e PD-së dhe LSI-së në Komisionin e Integritimit kërkuar masë disiplinore ndaj ministrit të Jashtëm, Bushati. Përmasë një reagimi pas debatit mes Bushatit dhe Pollos, që shkoi deri në fyerje personale, anëtarët e opozitës në Komisionin e Integritimit Europian shprehën se janë "të skandalizuar nga sjellja dhe gjuha rrugaçerore e z.Ditmir Bushati". Sipas tyre, pas një fjalimi tërësisht të politizuar dhe në mënyrë të paprovokuar, Bushati në mungesë të argumenteve dhe si pasojë e dështimit të axhendës integruese, në mbrojtje të vetvetes zgjodhi të ofendojë personalisht kryetarin e komisionit, Genc Pollo dhe vijoi të përgojonte dhe deputetë të



Faksimile të letrave të PS-se dhe PD-së

tjerë të opozitës. "Ne, anëtarët e komisionit, e dënojmë këtë akt jo vetëm si shprehje të sjelljes personale, por edhe institucionale të Bushatit. Ky akt është i papranueshëm dhe i dënueshëm. Ne refuzojmë të pranohet nga Bushati apo çdo person tjetër i thirrur në dëgjësë, përfshi edhe anëtarët

e qeverisë një sjellje të tillë, e cila nuk do të tolerohet më në komisionin tonë", thuhet në deklaratën e firmosur nga deputetët e PD-së e LSI-së. Por anëtarët e majtë në komision shkruajnë se kryetari Pollo cenoi dinjitetin e ministrit, duke përdorur fjalë tërësisht joetike si halabak e rrugaç.

REFORMA ZGJEDHORE

PD, Halimi: Grup pune për deputetë me rekorde kriminale

Këshilli i Rregullores Kushtetuese dje mes debatesh të shumta mes mazhorancës dhe opozitës dhe me dyer të mbyllura kodin e etikës. Deputeti demokrat, Eduard Halimi, akuzoi: "Ka deputetë, të cilët kanë lidhje me krim dhe me njerëz të botës së krimit. Ka deputetë, të cilët kanë përfutur fonde publike në emër të tyre apo familjarëve të tyre, përfshirë edhe një situatë të rëndë që ka të bëjë me drejtimin arbitrar dhe arrogant të Parlamentit nga kryetari i Parlamentit". Halimi bëri me dije se shume shpjet do të dilet me një dokument për mënyrën e paktimit të Kuvendit nga deputetë të Parlamentit kriminale. Ai njoftoi ngritjen e një grupi pune me deputetë të grupeve parlamentare, që të adresojë këto shqetësime që kanë të bëjnë me një hartimin e një kuadri ligjor. "U ra dakord që një grup pune me deputetë të grupeve parlamentare të adresojë këto shqetësime që kanë të bëjnë me hartimin e një kuadri ligjor, i cili duhet të pastrojë Parlamentin nga rekordet kriminale", u shpreh ai. Kjo u konfirmua edhe nga deputetja socialiste, Vasilika Hysi. "Ftohen të gjitha grupet parlamentare në Kuvendin e Shqipërisë, të gjithë deputetët të shprehin opinionin dhe sugjerime për ta përmirësuar këtë draft brenda dy javëve. E dëta, u ngrit një grup pune i përbërë nga tre deputetë për të mbledhur sugjerimet dhe për t'i parashtruar në projektin e kodit të sjelljes", u shpreh zj.Hysi. Kodi i etikës, që pritet të diskutohet në Kuvend parashikon mënyrën se si deputetët duhet të sillen, ndërsa i pengona ta të përfutojnë dhurata.

DEBATI NË KOMISIONIN KUVENDOR TË INTEGRIMIT

Genc Pollo: Je i ftuar në mbledhje për të shpjeguar funksionet që mbulon. **Ditmir Bushati:** Kaq shumë e kemi përmendur krimin e organizuar, kanabisin saqë kam frikë se do vij Hollivudi për të bërë një film për mafien shqiptare. **Genc Pollo:** Po kushërinë famshëm, Moisi Habllaj duhet të ketë një rol në këtë film që do xhirohet? **Ditmir Bushati:** Agjentë të specializuar do vijnë në Shqipëri për të kontrobuar për fazën e re të luftës ndaj krimit të organizuar. **Genc Pollo:** Ka mundësi të mbyllesh gojën bashkë me mikrofonin? **Ditmir Bushati:** Nuk e mbyll mikrofonin pa kërkuar ndjesë për fjalorin prej një vagabondi që përdore ndaj meje. Saliun kuq nuk e bën dot me mua. Fjalorin rrugaç, vagabond, arrogant që u përdor nga ana jote për mua, unë nuk e pranoj dot. Dua të mbroj dinjitetin e shtetit shqiptar dhe dinjitetin tim. E refuzoj këtë çorbë. Kjo i shkon vetëm Saliut. Salikuq nuk kam njohur, e pashë sot. Në rast se nuk kërkon ndjesë për fjalorin që përdore, nuk jam më i gatshëm për ta vazhduar këtë mbledhje. Murr pranohj epitetin rrugaç, e kthep mbrapsht me neveri. Merrë mbrapsht nëse do që seanca të vazhdojë. Mund të mos kesh asnjë lloj konsiderate për mua, por këtu jam ministër i Jashtëm dhe përballë të kam ty si kryetar komisioni. **Genc Pollo:** Në komisione përdorim numrin shumë. Është e fundit gjë që një i ftuar, përfshirë dhe ministër, mund t'i thotë kryetarit duke gjykuar ndershmërinë e tij. Privatisht mund të mendoni çfarë të doni, personalisht mund të keni idetë tuaja, shprehje e thënë në mikrofon të gjyko-sh ndershmërinë e kryetarit, vetëm një person me edukatë rrugaçi mund ta shprehë. **Ditmir Bushati:** Komisioni drejtohej më mirë nga Majlinda Bregu. Ti nuk je simboli i ndershmërisë këtu. Kthe fjalën mbrapsht, mos më bëj me gisht mua, gishtin ulë. Hiqi dhe dy gishtat. Kërko ndjesë. **Genc Pollo:** Lëri këto komente prej rrugaçi. **Ditmir Bushati:** Më nderon shumë kur ma thua emrin dhe mbiemrin që kam. Nuk lejoi as ty, as Saliun tënd të më thonë mua rrugaç. Unë nuk e vazhdoj këtë mbledhje pa kërkuar falje. Mua nuk më fyen dot. Kafën, drëkën dhe darkën di unë se më kë e ha. Mua këtu më trajton vetëm si ministër të Jashtëm. Për sa kohë nuk e ke kriterin elementar të edukatës, nuk mund ta vazhdoj këtë seancë. Mos u ndje i provokuar nga ajo që unë thashë për Bregun, me të cilën unë kam pasur debate shumë të aspra, por nuk e kemi kaluar kurrë cakun. **Genc Pollo:** Në mënyrë të paprecedentë në eksperiencën time parlamentare... ka mundësi të mbyllesh gojën dhe mikrofonin. **Ditmir Bushati:** Kërko ndjesë të madhe për ndotjen që shikatohe. **Genc Pollo:** Që të mos kemi nevojë për shërbimet e Gardës. **Ditmir Bushati:** Po lëri shërbimet e Gardës. Saliun kuq nuk e bën dot me mua. Erdha këtu për t'i dhënë përgjigje secilit prej jush. Por fjalorin rrugaç, vagabond që u përdor këtu dhe nuk e pranoj dot. Kjo i shkon vetëm Saliut. Salikuq unë nuk kam njohur, po shoh sot. Nëse nuk kërkon ndjesë për fjalorin, unë nuk jam i gatshëm për ta vazhduar më këtë mbledhje. Ju kërkoj shumë ndjesë për veprimin abuziv të kryetarit të komisionit. Pres ndjesën e kryetarit. Sa kohë nuk ka një ndjesë nga kryetari i këtij komisioni, unë nuk vazhdoj dot të jem në një ambient të ndotur nga kryetari. Saliu ju bë 74, u bëftë 100! Salikuq nuk shkoi, ka marrë fund koha. **Genc Pollo:** Fatkeqësi që kemi njerëz të tillë, edhe ju kolegë socialistë, halabakë komplet.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,046,800 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë parapaskisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **09 Nentor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Tatimet paralajmërojnë bizneset

“Dorëzoni librat e shitblerjes, përndryshe gjobë 10-50 mijë lekë”

Drejtoria e Tatimeve u ka dërguar shkresa subjekteve VIP që të dorëzojnë librat e shitjes për muajin shtator, përndryshe ata do të dënohen me gjoba nga 10 në 50 mijë lekë për mosdhënie informacioni. Librat e shitblerjes për çdo muaj dorëzohen online deri në datën 10 të muajit pasardhës. Sipas njoftimit të tatimeve dërguar subjekteve, "Nga raportimi i të dhënave mbi deklarimin e librave të shitjeve dhe blerjeve, rezultoni se subjekti juaj nuk ka dorëzuar librin e shitjeve dhe librin e blerjeve për periudhën tatimore shtator 2017 sipas

afateve të parashikuara në ligj. Konkretisht referuar Ligjit nr. 92/2014 "Për tatinin mbi vlerën e shtuar në RSH" si dhe Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 në zbatim të tij përkatësisht Neni 68. pika5. dhe vendimit nr.922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarimeve tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike" afati i fundit i dorëzimit të librit të shitjeve dhe blerjeve është

data 10 e muajit që pason periudhën tatimore që deklarohet. Për sa më sipër, kërkojmë vëmendjen tuaj maksimale për dorëzimin sa më parë të librave në zbatim se më korrekt të kërkesave ligjore për të shmangur çdo dënim në zbatim të nenit 126 të Ligjit të Procedurave Tatimore nr. 9920, datë 19. 05. 2008, i ndryshuar", përfundon njoftimi i tatimeve. Sipas ligjit të procedurave tatimore, neni 26 për mosdhënie informacionit san-

skionon se "Refuzimi për dhënie informacioni të kërkuar nga administrata tatimore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, dënohet me gjobë me 10 000-50 000 lekë për çdo shkelje". Që nga fillimi i këtij muaji tatimet kanë nisur aksionin antiinformalitet. Sipas një njoftimi të djeshëm të tatimeve, për dy javët e para të fushatës është mundur përfundimi i 4,773 kontrolleve (kontrolle nga zyra, vizita fiskale apo verifikime në



terren) ku kontrollet nga zyra përbëjnë 73 % të totalit, këto kontrolle u shoqëruan me më shumë se 170 milionë lekë gjetje dhe raportit gjetjeve me penalitete është në masën 70% me 30%.

810 subjekte kanë ndryshuar përgjegjësinë tatimore, ku Tirana ka dhe numrin më të madh me 430 subjekte, e ndjekur nga Vlora me 84 dhe Durësi me 77.

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë shpall konkursin për 11 vende vakante

Çmimi i energjisë, OSHEE: Nuk do kërkojmë rritje

Aplikimet, deri më datë 6 nëntor

Ornela Manjani

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nuk do të kërkojë rritje të tarifës për vitin 2018. Në një dalje për mediat administratori i OSHEE, Adrian Çela iu përgjigj interesit të medias lidhur me aplikimin e kompanisë së shpërndarjes për një rishikim të mundshëm. "Ne jemi duke bërë llogaritjet tona, dhe jemi të predispozuar që të mos kemi një rritje të tarifës. Kemi nisur procedurën standarde që kërkohet në bazë të rregulave për të bërë aplikimin, por aktualisht jemi në fillim të llogaritjeve. Rritje nuk do kemi, nëse do të kemi ulje, do ta bëjmë me dije", tha administratori Çela. ERE nga ana tjetër është në pritje të aplikimeve të operatorëve të tregut dhe paralelisht me këtë ka bërë të qartë edhe metodologjinë që do të ndiqet për të vlerësuar këto tarifa. Mendryshimin e modelit të tregut edhe aplikimet si dhe caktimi i tarifave pritet të jetë më kompleks për vitin në vijim. Pritshmëria që kompanitë të kërkojnë një rishikim për të përmirësuar financat e tyre vjen në kushtet kur Korporata Elektroenergjetike Shqiptare pati një rënie të dukshme të prodhimit këtë vit e për rrjedhojë edhe një rënie drastike të të ardhurave. OSHEE, nga ana tjetër, ka shpenzuar rreth 100 milionë euro për importe dhe ka nevojë për të vijuar investimet e saj në rrjet në funksion të uljes së humbjeve si dhe përmirësimit të cilësisë së furnizimit të konsumatorëve. OST mbetet akoma e mbërthyer me një seri kredishe dhe overdraftesh të viteve të kaluara që i kanë shërbyer për investime si dhe për linjat 400 kv që janë tashmë të përfunduara. Gjithsesi operatorët kanë ende kohë për të paraqitur

aplikimet e tyre që në linjë të trasha marrin parasysh shpenzimet për operimin dhe planin e investimeve. **SHKARKIMET** Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ka shpallur të hapur konkursin për 11 vende vakante. Bëhet fjalë për postet e drejtorëve rajonale për 11 drejtoritë rajonale të kësaj shoqërie. Bashkë me njoftimin, OSHEE ka publikuar edhe kriteret që duhet të përmbushin kandidatët e interesuar. Kandidati duhet të zotërojë një diplomë të nivelit master shkencor,



ndërsa degët e preferuara janë ato në shkencat inxhinierike, ekonomike dhe juridike. Në kriteret përfshihet edhe pasja e së paku 5 viteve përvojë pune, me një eksperiencë të preferuar në drejtim ose menaxhim. Krahas këtyre kushteve, kërkohen edhe njohuria e mirë e gjuhës angleze dhe aftësi të mira kompjuterike. Për të aplikuar, të interesuarit duhet të dorëzojnë një letër interesi për pozicionin në të cilin po konkurojnë; jetëshkrimin; tabelën e plotësuar me të dhënat për aplikant sipas modelit të përcaktuar

VENDET VAKANTE

1. Drejtoria Rajonale Tiranë
2. Drejtoria Rajonale Durrës
3. Drejtoria Rajonale Elbasan
4. Drejtoria Rajonale Gjirokastrë
5. Drejtoria Rajonale Korçë
6. Drejtoria Rajonale Shkodër
7. Drejtoria Rajonale Fier
8. Drejtoria Rajonale Berat
9. Drejtoria Rajonale Burrel
10. Njësia Kukës
11. Njësia Vlorë

nga OSHEE; si edhe formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore. Aplikimet do të priten deri më datë 6 nëntor pranë OSHEE, datë pas së cilës do të bëhet përzgjedhja e kandidatëve dhe do të zhvillohet faza e intervistës me gojë dhe testimit me shkrim.

Komisioni European skanon ekonominë shqiptare

Ecuria pritet pozitive, rritja e PBB-së reale ishte 4.1%



Devollit. Eksportet neto kontribuan pozitivisht, sidomos si rrjedhojë e shërbimeve që u zgjeruan me 22.0 %, përfshirë turizmin dhe transportin. Eksporti i mall-

rave (+4.4 %) u zgjerua për të tretin tremujor radhazi, duke konfirmuar rikthimin e trendit rritës, pas tre viteve rënie. Në kahun e prodhimit, aktiviteti i ndërtim-

it shënoi rritjen më të lartë me 22.7 % me bazë vjetore, duke reflektuar kulmin e aktivitetit të investimeve në sektorin e energjisë. Aktivitetet financiare dhe të sigurimeve (+10.6 %) dhe pëpunimi (+6.3 %) kishin, gjithashtu, ecuri të fortë. Të dhënat sugjerojnë se aktiviteti ekonomik ka vazhduar zgjerimin dhe në tremujorin e tretë, besimi i konsumatorëve është përmirësuar dhe ai i bizneseve mbetet në nivele të larta. Tregu i punës ka pasur zhvillime të favorshme në tremujorin e dytë.

Punësimi është rritur, ndërsa papunësia ra në 14.3% dhe papunësia tek të rinjtë zbriti me 3.4 pikë përqindje në 26.4 %. Pagat u rritën me 11%, kryesisht si rrjedhojë e rritjes së pagave në sektorin shtetëror. Rritja e kredisë për ekonominë ishte negative, që nga muaji prill (-0.2 % me bazë vjetore në gusht), që është gjithsesi rrjedhojë e zhvlerësimit të monedhave të huaja ndaj lekut. I rregulluar për efektin e kursit të këmbimit, kredia për bizneset dhe konsumatorët u rrit përkatësisht me 2.0 % dhe 7.5 % me bazë vjetore. Rritja e ulët e kredisë reflekton pjesërisht rregullimin e kredisë me probleme, përfshirë shfrytëzimin nga bilanci, thekson raportin.

DURRËS - Një punonjës policie për është arrestuar për "Shpërdorim detyrë" në qytetin e Durrësit, pasi mundësoi pajisjen me armë të një personi me precedentë penalë. Kështu, SHÇBA në bashkëpunim me Prokurorinë e Durrësit kreu një hetim gati 2-javor për nënkomisar Gjergji Azisllari, me detyrë specialist për Hetimin e Krimeve në stacionin policor Plazh, Durrës. Mësohet se ky punonjës ka përpiluar vërtetimin



SHÇBA vë në pranga nënkomisar Gjergji Azisllari

Pajisi me armë një person me rekorde kriminale, arrestohet polici në Durrës

e besueshmërisë për shtetasin me rekorde kriminale, Genti Nderjaku, i cili ishte pajisur me armë zjarri për në banesë. Nderjaku u arrestua nga Policia e Durrësit gjatë një operacioni të zhvilluar në fillim të tetorit, në kuadër të operacionit policor "Vjeshtë 2017". Bashkë me të policia arrestoi edhe Mariel Fierzën, si dhe u sekuestruan 2 armë zjarri, një makinë dhe disa telefona celularë. Pas veprime procedurale të SHÇBA-së, rezultoi se i arrestuari është person me rekorde kriminale, por kishte ndryshuar gjeneralitetet. Punonjësi i policisë, Azisllari nuk ka kryer verifikimin në sistem sipas

procedurave standarde të punës. Gjatë hetimit ka rezultuar se po ky punonjës policie kishte përpiluar të njëjtin lloj vërtetimi edhe për Mariel Fierzën, i cili gjithashtu rezultoi me rekorde kriminale në të dhënat e Policisë së Shtetit. Nderkaq, SHÇBA ka nisur një inspektim në të gjitha Drejtoritë Vendore të Policisë për procedurat e ndjekura nga strukturat përgjegjëse, për pajisjen me leje për blerje dhe mbajtje të armëve të zjarrit.

Shullazi, Konit: Pse u kërcënove? Unë i them edhe drejtorit të burgut "jep dorëheqjen"

Gjyqi ndaj Shullazit, profesorët Konit e Kule nuk e thonë emrin e kërcënuesit

Lindita Nikolla "rrëzon" Tahirin: Ishim me të kur foli Berisha

Xhensila Kodra

Dy profesorët, Mynyr Koni dhe Dhori Kule dëshmuar dje në gjyqin ndaj Emiljano Shullazit dhe miqve të tij, të cilët pohuan kërcënimet, por në asnjë rast nuk e përmendën atë me emër. Po ashtu, dje në gjykatën e Krimeve të Rënda dhanë dëshminë e tyre edhe ministrja e Arsimit, Lindita Nikolla, si edhe ish-drejtori i Policisë së Tiranës, Ervin Hodaj. Mynyr Koni dhe Dhori Kule, të cilët sipas prokurorisë ranë pre e një kërcënimi nga të pandehurit, nuk mundën të ngrinin gishtin e akuzës ndaj Shullazit. Të dy u justifikuan se në disfavor të tyre ishte errësira dhe koha e shkurtër. Rektori aktual i Universitetit të Tiranës, Mynyr Koni, i cili në prill të 2016 ishte në garë për këtë post, u shpreh se në mënyrë ultimative se persona të panjohur prej tij i kërkuan të tërhiqej nga kandidimi. Dhori Kule tregoi për mënyrën se si persona që ai nuk i njohte i kishin kërkuar që të mos e pengonte dorëheqjen e Mynyr Konit. Në seancë, gjatë deklaratave të tyre, ministrja Nikolla dhe ish-drejtori i policisë, Hodaj treguan për mënyrën se si u informuan për kërcënimet e dy profesorëve.

MYNYR KONI

Rektori Mynyr Koni tregoi para togave të zeza për kërcënimin që kishte marrë, që e detyroi atë të dorëhiqej nga gara. "Mbrëmjen e 14 prillit 2016, sapo kisha dalë nga zyra, kur një makinë e zezë, tip 'Benz' mendoj, u ndalua te këmbët e mia dhe dikush më kërkoi të hipja në të. Instinktivisht u futa në automjet. Një person më kërkoi në mënyrë të prerë të hiqja dorë nga gara për rektor. I pyeta përse duhet ta bëja, por personi ma përsëriti kërkesën. U trondita dhe pasi njoftova stafin për ndërprerjen e fushatës zgjedhore, fika telefonin dhe erdha në shtëpi. Kam komunikuar vetëm me Dhori Kule. Ai erdhi në shtëpinë time dhe i rrëfëva kërcënimin, por s'kam folur me të për asnjë emër konkret. Më vonë, në shtëpinë time erdhi drejtori i policisë së Tiranës dhe më shoqëroi në një takim me ministrin e Brendshëm në atë kohë, Saimir Tahirin. E pranishme ishte dhe ministrja e Arsimit. Ministri i Brendshëm, Tahir, më garanto mbrojtje dhe unë u riktheva në garë", dek-

laroi ai. Nderkaq, në një moment, Emiljano Shullazi ndërhyri duke pyetur profesor Kule se përse ndihej i kërcënuar, ndërsa pohoi se, "unë i them edhe drejtorit të burgut 3 herë në ditë jep dorëheqjen, sepse nuk më pëlgen. Kjo do të thotë se po e kërcënoj?".

DHORI KULE

Dekani i Fakultetit Ekonomik, Dhori Kule deklaroi dje për momentin e kërcënimin të tij dhe përse fillimisht u duk si lojë. "Ndodhësia me dy miq, kur tri makina erdhën me shpejtësi. Dolën disa djem dhe më kërkuan të afrohesha te makina e dytë. Aty një person ulti xhamin dhe më tha: 'Mos pengo dorëheqjen e Mynyr Konit'. Fillimisht mendova se ishte shaka. I thashë atij personi pse, sepse ai është burrë i mirë, ndërsa po ai person më përsëriti po të njëjtën gjë. Koha ishte aq e shpejtë, sa që unë nuk arrita t'i identifikoj personat dhe as targat e makinave". Më tej, i pandehuri Emiljano Shullazi e pyeti drejtpërdrejtë



Emiljano Shullazi

profesorin nëse ai ngjante me personin që e kërcënoi, por Koni iu përgjigj: "Aq shpesh të kam parë në televizion sa vështirë të them se më ngjan me atë person".

LINDITA NIKOLLA

Dëshmitarja e radhës ishte ministrja e Arsimit, Lindita Nikolla, e cila përmasë rrefimit përgjeshitroi dëshminë e ish-kolegut të saj, Saimir Tahirin. "Për kërcënimin më informoi Dhori Kule. Mora masat, pasi integriteti dhe jeta e profes-

orëve ishte në rrezik. Telefona drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Haki Çakoni dhe gjatë bisedës, Kule u shpreh se dyshonte se ishin njerëzit e Shullazit. Gjatë takimit mëspashëm me ministrin e Brendshëm, Saimir Tahirin, u njoftuan se doli në konferencë Berisha, duke denoncuar ngjarjen në fjalë". Me këtë deklaratë që Nikolla bëri dje para togave të zeza rrethoi alibin e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahirin, i

cili një seancë me herët këmbënguli se lajmin e kërcënimin e mësoi nga denoncimi publik i bërë nga ish-kryeministri Sali Berisha. Nderkaq, edhe gjykata insistoi në këtë pikë, kur e pyeti profesor Dhori Kule nëse kishte pasur donjë komunikim me Sali Berishën për çështjen në fjalë, pasi nga gjykimi rezultoi se vetëm ish-kryeministri ka guxuar të përmendë direkt Shullazin si të përfshirë në ngjarje. Por, dekani refuzoi ta kishte bërë një gjë të tillë.

ERVIN HODAJ

Në vazhdim të këtij procesi gjyqësor, dëshmitari i radhës që u përball me të pandehurin Emiljano Shullazi dhe miqtë e tij ishte ish-drejtori i policisë së kryeqytetit, Ervin Hodaj. Gjatë seancës, në një moment mes Shullazit dhe Hodajit pati edhe një përplasje. Emiljano Shullazi kërkoi të dijë nga Hodaj se mbi çfarë provash u shoqërua në polici dhe kush ia kishte dhënë emrin e tij, por nuk mori përgjigje nga zyrtari i policisë.



Përdhuni e la shtatzënë të miturën, burg autorit

Gjykata e Pogradecit vendosi dje masën e sigurisë "arrest me burg" për Ligor Bibën, i akuzuar për përdhunimin e një 15-vjeçareje, e cila aktualisht është disamuajshe shtatzënë. Në seancë nuk kanë qenë të pranishëm as familjarët e së miturës dhe as ata të autorit të dyshuar. Ngjarja për të cilën akuzohet Biba ka ndodhur në Velcan të Pogradecit disa muaj më parë. Por, denoncimi ndaj tij u bë para disa ditëve, kur nëna e vajzës kishte zbuluar shtatzëninë e së bijës. Gjatë dëshmisë që 15-vjeçarja ka dhënë në polici ka pohuar se nuk kishte mundur të tregonte në momentin që kishte ndodhur ngjarja, për shkak se i vinte turp nga njerëzit e fshatit ku ajo jetonte. I akuzuari nuk e ka pranuar autorësinë, ndërsa pak ditë më parë, edhe vajza e 55-vjeçarit Biba deklaroi për mediat se këto akuzat janë të pabaza e të stisura.

Dje policia arrestoi 2 persona me qëllim ekstradimi

Gjykata lë në burg me afat 40-ditor të kërkuarin në Itali, Riza Sheshin

Gjykata e Durrësit vendosi të lërë në "arrest me burg" me afat 40 ditë shtetasin Riza Sheshi, i arrestuar pak ditë më parë me qëllim ekstradimi drejt Italisë. 50-vjeçari nga Shijaku ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar, pasi Gjykata e Xhenovës në Itali kishte lëshuar një urdhër arresti ndaj tij, duke e akuzuar për veprën penale të "pjesëmarrjes në organizata kriminale me qëllim shfrytëzimin prostitucioni". Mbrojtja deklaroi se arrestimi i Sheshit është kryer mbi bazën e një dokumentacioni të parregullit dhe kërkoi ndryshim të masës së sigurisë ndaj

tij. Nderkaq, ditën e djeshme, Policia e Durrësit ndaloi dy persona të shpallur në kërkim ndërkombëtar, me qëllim ekstradimi drejt Italisë, konkretisht Arben Plaku 51 vjeç dhe Resmije Rrahmani 57 vjeç, motër e vëlla. Gjykata e Xhenovës kishte nxjerrë për Arben Plakun urdhër-arrestit për veprat penale "Pjesëmarrje në organizata kriminale", "Shfrytëzimin prostitucioni", "Vjedhje me dhunë" dhe "Kontrabandë të personave", ndërsa Resmije Rrahmani ishte dënuar me 3 vjet burg për veprën penale "Shfrytëzimin prostitucioni në bashkëpunim".

Policia sekuestron një gomone me vlerë 150 mijë euro në Vlorë

VLORE - Policia e Shtetit vijon operacionin "Vjeshtë 2017". Në kuadër të këtij operacioni, policia e Vlorës ka sekuestruar një mjet lundrues tip gomone me vlerë 150.000 euro. Burime zyrtare nga policia bënë dje me dije se specialistët Seksionit për Krimin Ekonomik e Financiar në Drejtorinë Vendore të Policisë, Vlorë, në kuadër të veprimeve të para hetimore bënë të mundur sekuestrimin e një mjeti lundrues tip gomone me vlerë 150.000 euro. Sipas policisë, mjeti lundrues i përket shtetasit A.C., 29 vjeç, banues në Elbasan, i cili dyshohet për kryerjen e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për veprime të mëtejshme procedurale. Ndërkohë, policia e Vlorës do të vijojë punën lidhur me zbatimin e ligjit për vënien para përgjegjësisë ligjore, duke sekuestruar të gjitha asetet, të cilat rezultojnë të përfituara në mënyrë të paligjshme.

VIP

Suplement
Pages

Emërkurë 18 Tetor

GAZETA SHQIPTARE

"BULEVARDI POLITIK"

- Mishi i dërrit drejt Indonezisë, Putin shpërthen në të qeshura
- Dasma madhështore, Princi i Etiopisë i jep fund beqarisë
- Kodheli: Historia që na lidh me Bashkimin Finon
- Bledi Çuçi promovon grupin muzikor nga Përmeti

Ermali zëvendëson Rashelën

Ja vajza superseksi që të lë pa frymë




Publikohet spoti i programit



Robert Aliaj:

Anëtari i jurisë flet për ngjarjet e fundit në "Dance With Me"



**Në jetë, kurs' ke para, duhet të kesh stil.
Keqkuptimi vjen nga ata që nuk kanë asnjërin**

"Unë iu adresova audiencës, të gjithë e dinë gjuhë lehtë gratë e shkrata"

Anëtari i jurisë flet për ngjarjet e fundit në "Dance With Me"

Robert Aliaj:

Në jetë, kur nuk ke para, duhet të kesh stil. Keqkuptimi vjen nga ata që nuk kanë asnjërën *"Unë iu adresova audiencës, të gjithë e dimë çfarë heqin gratë e shkreta"*

Pamela ALIAJ

Pas bujës që bëri debati mes gazetares së njohur Fiori Dardha, konkurrente në show-n e njohur, "Dance with Me" dhe njërit prej anëtarëve të jurisë, ka folur ekskluzivisht në një intervistë për "Vip Pages" të "Gazeta Shqiptare", Robert Aliaj. Përpos prapaskenave dhe atyre që u thanë publikisht, Roberti ka folur për atë që u keqkuptua ose nuk u kuptua aspak nga ana e konkurrentes. Gjithashtu, ai foli edhe për marrëdhëniet që kishte me konkurrenten tjetër të këtij emisioni televiziv, transgjinioren Linda Rei. "Për mua ishte tmerrësisht e vështirë të gjykoja një burrë që kërcente si vajzë e vogël e përkëdhelur dhe pretendonte që ishte grua", ka thënë ai. Këto dhe të tjera në intervistën më poshtë.

Jeni një nga anëtarët e jurisë së DWM më karizmatikë dhe unikë në stilin dhe gjykimin tuaj. Pse haseni shpesh me debate, të cilat më vonë banalizojnë në sharje? Pse gjithë ky keqkuptim ndaj jush?

Bob Marley thoshte: Në jetë, kur nuk ke para, duhet të kesh stil. Keqkuptimi vjen nga ata që nuk kanë asnjërën.

Nga ngjarjet e fundit në DWM janë larguar dy konkurrente, Linda Rei dhe Fiori Dardha. Me këtë të fundit keni pasur edhe debatin e fundit publikisht. Pse u banalizua në personal debati?

Unë nuk shoh televizor, nuk kam televizor fare në shtëpi, kur ta shoh të them.

Çfarë mendimi keni për reagimin e Fiorit ndaj fjalëve tuaja? Pse e mori personale?



Populli ka një shprehje kur të djeg miza nën kësulë. Pse personale? Mentalitet provincial.

Gjatë debatit me Fiorin ndërhyri edhe aktori Mehdi Malkaj, i cili ju kërkoi të jepnit dorëheqjen nga DWM. Pse një reagim i tillë? A keni pasur debate edhe me të?

Haha, ai u ngatërrua me veten e tij, nuk ia ve re, gjëra që ndodhin. Bën shumë nxehtë në atë studio.

Ju thatë gjatë njëris nga pun-

tatat se "disa gra, pasi dalin nga këtu edhe hanë dajak". Pse Fiori e mori personale?

Mesa duket ajo e kuptoi më mirë nga të tjerët atë që thashë unë. Por unë iu adresova audiencës. Rregull bazik i skenës. Të gjithë e dimë çfarë heqin gratë e shkreta.

Çfarë menduat në momentin që Fiori përmendi gruan tuaj dhe hodhi mikrofonin drejt jush. Pse arriti një sjellje të tillë deri në banalitet?


Mendova që ky ishte shembulli më ekstrem i hipokrizisë dhe injorancës, të miksuara bashkë me histeri në jetën time, sepse një grua që pretendon se kërkon të mbrojë kauzën e gruas, nuk ofendon një tjetër grua që nuk është prezent, dhe aq më keq, që as nuk e njeh fare.

Si i keni pasur marrëdhëniet me ish-konkurrenten Linda Rei?

Distançë.

U duk në fillim sikur shkonit mirë bashkë, por më pas, patët një debat ku ju iu drejtua Reit duke thënë se 'Kur ka njerëz si puna jote që bëjnë ndërhyrje, ne na vjen të vëmë në uturak.' Pse ky reagim?

Për mua ishte tmerrësisht e



vështirë të gjykoja një burrë që kërcente si vajzë e vogël e përkëdhelur dhe pretendonte që ishte grua. Imagino mamën tënd që të thotë një ditë: Unë nuk jam femër, jam mace. Ha haaaaaaa. Do e besojë ti?

A keni pasur debate apo "konflikte" me personazhe të tjerë në DWM?

Ke parë gjë ti?

Duke qenë se Fiori Dardha u largua, a ka pasur ndonjë tentativë jashtë kuintave t'i ndryshonit mendje? A keni pasur "debate" me produksionin lidhur me këtë çështje?

Beson ti që pacienti mbasi ia kanë shtrydhur çibanin, t'i kërkojë doktorit t'ia rikthejë qelbin?



PUBLIKOHET SPOTI I PROGRAMIT, MARINA MË SENSUALE SE KURRË

Është folur shumë për programin e ri të "Tv Klan", që do të prezantohet nga Marina Vjollca. Pasi u zbulua titulli i tij dhe konkurrentët, mbetet të mësohet vetëm data e fillimit, por duket sikur produksioni ka ende punë deri sa ta vendosë, ndërsa Marina ka vazhduar me muajin e mjalit. Megjithatë, është publikuar spoti reklamues me një Marinë më sensuale sesa kurrë. Sigurisht kështu vëmendja mbahet në maksimum. E shtrirë në shtrat, veshur me një këmishë mëndafshi, Marina duron fjalët e shpejta të një papagalli dhe duke iu përgjigjur atij zbulon orën e fillimit të programit. Programi "C'est la vie" do të fillojë në orën 8 të mbrëmjes, të dielën. Një jastëk i fluturuar mbi televizorin që transmeton ndeshje duket sikur tregon që Marina i ka dhënë fund tashmë programeve sportive dhe të dielën të gjithë ata që nuk i pëlqejnë ndeshjet, kanë një alternativë tjetër në ekran, programin e prezantuar nga Marina Vjollca. Fillon... së shpejti!




PASI E PËRMENDI NË SPEKTAKËL, FIORI "PLAS BOMBËN" NDAJ ALKETA VEJSIUT

Largimi i saj nga spektakli i vallëzimit "Dance with me" ishte i bujshëm dhe i papritur. Pas debateve të njëpasnjëshme me anëtarin e jurisë Robert Aliaj, gazetarja Fiori Dardha la garën pa u menduar dy herë. Nuk ishin të paktë zërat që donin rikthimin e saj në pistën e vallëzimit. Fiori u kthye sërisht me një përgjigje përfundimtare, duke thënë se rrugëtimi i saj në "Dance with me" kishte përfunduar. Gjatë mbrëmjes së të hënës moderatorja Alketa Vejsiu kishte dy fjalë për Fiorin. "Jam shumë e kënaqur që e kam njohur Fiorin përmes vallëzimit. Vallëzimi na ka bashkuar, nuk na ka ndarë në këtë spektakël", ka thënë Alketa duke lënë të kuptohet se tensionet janë shuar. Të njëjtën gjë ka konfirmuar dhe Fiori. Sapo moderatorja bëri publikimin e një fotoje në rrjetin social "Instagram", ajo i lë një koment ku duket e mahnitur nga çfarë i shohin sytë.



Ermali zëvendëson Rashelën

JA VAJZA SUPERSEKSI QË TË LË PA FRYMË



Publiku i emisionit "Xing me Ermalin" me siguri do të mbesë pa fjalë në serinë që do ta transmetohet në ekranin e televizionit "Tv Klan" këtë të shtunë, dhe shkak për këtë do të jetë pikërisht velina e re e spektaklit. Bëhet fjalë për Kejvina Kithellën, bukuroshja e re që do të shoqërojë në emision moderatorin Ermal Mamaqi. Modelja superseksi me linjat bombastike ka mbërritur enkas nga Italia ku jeton prej vitesh, për t'u bërë pjesë e spektaklit të humorit "Xing me Ermalin". Bukuroshja bionde me sytë e kaltër numëron rreth 9 mijë ndjekës në llogarinë e saj në "Instagram" dhe njihet për fotot tepër provokuese të realizuara gjatë karrierës si fotomodelle.



BULEVARDI

Na merrni seriozisht!

POLITIK

Mishi i derrit drejt Indonezisë, Putin shpërthen në të qeshura

Presidenti rus Vladimir Putin nuk mban dot të qeshurën gjatë një takimi të kabinetit, pasi ministri rus i Bujqësisë, Aleksander Tkaçev, përmendi eksportimin e derrit në Indonezi. Sipas mediave të huaja Tkaçev po propozonte një plan për të rritur eksportin e mishit dhe dha një shembull të Gjermanisë në drejtim të eksportimit të mishit të derrit në disa vende si Japonia, Kina dhe Indonezia. Por ka qenë presidenti rus, Vladimir Putin ai që duke buzëqeshur ka sqaruar Tkaçevin se Indonezia është një vend mysliman, prandaj njerëzit atje nuk hanë mish derri, për të cilën ministri është përgjigjur me shaka "Do të hanë". Putini pastaj i thotë: "Jo, nuk do të hanë". Putin pastaj shpërthen në qeshje dhe Tkaçev pastaj buzëqesh dhe sqaron se ai donte të thoshte Korenë e Jugut dhe jo Indonezine.



Dasma madhështore, Princi i Etiopisë i jep fund beqarisë

Princi i Etiopisë i dha fund beqarisë në moshën 35-vjeçare, pasi u martua me amerikanen 33-vjeçare Ariana Austin. Të dy ishin njohur në një "night" në Washington DC, 12 vjet më parë, ndërsa vendosën të kurorëzohen martesën vetëm vjeshtën e këtij viti. Dasma u zhvillua më 09 shtator të këtij viti, në Maryland, në një ceremoni të denjë për një familje mbretërore. Princi maroken Joel Makonnen ka lindur në Romë, atje ku familja e tij jetoi në mërgim, që prej grushtit ushtarak të 1974-ës.

Kodheli: Historia që na lidh me Bashkim Finon

Në Komisionin e Jashtëm po diskutohej javën e shkuar ligji për minoritetet. Kishin nisur ndërkohë debatet dhe propozimet e deputetëve, ndërsa në sallën e komisionit futet deputeti socialist Bashkim Fino. Kryetarja e Komisionit të Jashtëm, ish-ministria Mimi Kodheli, pa dashur t'i thotë gjë për vonesën në mbledhje thotë një batutë dhe më pas tregon një histori të hershme, siç e cilësoi ajo. "Mirë se erdhe zoti Fino. Se me Bashkimin kam një histori të hershme e s'dua të jem më shumë subjektive se sa jam", i tha Kodheli Finos, duke shkaktuar pak habi në sallë.



Bledi Çuçi promovon grupin muzikor nga Përmeti

Bledi Çuçi, ish-ministri i Shtetit për Çështjet Vendore është një nga përfaqësuesit e rëndësishëm që mbeti jashtë kabinetit qeveritar në mandatin "Rama 2". Pasi kjo ministri u shkri në mandatin e dytë qeverisës, Çuçi duket se ka gjetur një "profesion" të ri. Në profilin e tij në "Facebook", ish-ministri po promovon një grup muzikantësh nga Përmeti, që sipas tij kërkojnë mbështetje, pasi janë aspirant për tregun ndërkombëtar dhe se në 20 tetor do të mbajnë koncert në Tiranë. "Këta muzikantë të mrekullueshëm të Përmetit janë tani në rrugë për t'u bërë të njohur në tregun ndërkombëtar të muzikës, për hir të përkrahjes plot dashuri nga Joy Boyd, Andrea Goertler dhe Edit Pula. Për ju që jeni në Tiranë, mos mungoni në koncertin e këtij grupi, i cili do të mbahet në datë 20 tetor në Tiranë. Albumi i këtij grupi është një dhuratë e bukur që mund t'ia bëni vetes, njerëzve tuaj të dashur apo miqve tuaj nga jashtë që duan ta njohin më shumë muzikën popullore shqiptare", shkruan ish-ministri.

Ambasada: Regjistrimet para 18 tetorit, të pavlefshme, duhet t'i bëni sërish

Lotaria Amerikane, mbi 400 profesione që ju kualifikojnë 22 nëntori, afati i fundit për të aplikuar

Voltiza Duro

Sot, rifillojnë aplikimet për Lotarinë Amerikane për të gjithë ata që dëshirojnë të jetojnë e punojnë në tokën e premtuar. Kandidatët do të kenë mundësinë të plotësojnë formularin deri në datën 22 nëntor të këtij viti. Në njoftimin e publikuar dy ditë më parë, Ambasada Amerikane bëri me dije se të gjitha aplikimet para 18 tetorit janë të pavlefshme dhe duhet të ribëhen sërish. Edhe nëse përdorin të njëjtën foto të aplikimit të mëparshëm për DV-2019, kandidatët nuk penalizohen nga ky fakt. Individët, të cilët bëjnë më shumë se një regjistrim gjatë periudhës së re të regjistrimit do të

skualifikohen. Ndërkaq, ambasada ka theksuar edhe një herë dy nga kriteret bazë për t'u shpallur fitues, arsimin ose përvojën e punës. Për të përmbyshur kriterin e arsimit, aplikanti duhet të dëshmojë se ka një arsim të shkollës së mesme apo ekuivalentin e tij të përpunshëm me atë të SHBASë, i përkufizuar si përfundim i 12 viteve edukimi

plotë. Ndërsa për kriterin e punës duhet të ketë 2 vjet përvojë pune brenda pesë viteve të kaluara në një punësim që kërkon të paktën 2 vjet trajnim ose eksperiencë për ta ushtruar. "Vetëm disa profesione specifike kualifikohen për programin e Vizave të Shumëllojshmërisë. Për t'u kualifikuar për një vizë të lotarisë mbi bazën e ekspe-

riencës së punës, ju duhet të keni brenda pesë viteve të fundit dy vjet përvojë në një profesion që është përcaktuar si Zonë Pune 4 ose 5, e klasifikuar në Përgatitjen Profesionale Specifike (SVP) të vlerës 7.0 ose më lart. Profesionet kualifikuese të DV-së janë të renditura në Bazën e të dhënave të Departamentit të Punës O*Net Online Da-

tabase", theksohet në faqen zyrtare të ambasadës amerikane. Sipas të dhënave në këtë faqe, në zonat 4 dhe 5 janë publikuar më shumë se 400 përvoja pune me të cilat aplikanti mund të kualifikohet për programin e Lotarisë Amerikane DV-2019. Sot, në "Gazeta Shqiptare" mund të kontrolloni disa prej profesioneve që mund t'ju shpallin fitues.

RAPORTI



Ku kanë epërsi femrat më shumë se meshkujt në Shqipëri?

UNFPA publikon në 2017 raportin e fundit për gjendjen e popullsisë në botë. Ajo që spikat për Shqipërinë është situata e grave. Në përgjithësi vendi ynë ka rezultate më negative në botë përsa i përket diskriminimit gjinor, e ndodhet në krah të Azerbajxhanit dhe Armenisë. Pabarazia gjinore godet kryesisht kategorinë e grave të varfra. Edhe në pozicionet drejtues kemi shumë pak gra e jemi në vendin e 95 nga 142 vend të përfshira në studimin global të Kombeve të Bashkuara. Ndërkohë në lidhje me pagat Shqipëria shënon një arritje pozitive dhe një negative. Femrat shqiptare nuk preferohen të promovohen në pozicione drejtuese. Por nëse arrijnë të jenë në rol menaxherial, atëherë paguhen pothuajse njësoj si meshkujt. Përfaqësuesja e UNFPA për Shqipërinë, Manuela Bello ka bërë me dije dëmet që sjell në shoqëri disbalanca gjinore, ku një martesë e herëshme bën që grujat të mos ketë një punë të sigurt dhe ekonomia është e dobët. Ekspertët e UNFPA japin e sugjerime për drejtuesit e lartë që për të luftuar pabarazitë duhet të rrezojnë barrierat sociale dhe të mbështesin gratë se kështu potenciali i tyre do të dalë në pah e ato do të diskriminohen më pak, pasi do të fuqizohen ekonomikisht.

- Mësues studimesh rekreative dhe fitness;
- Këshilltar rehabilitimi;
- Psikolog shkolle;
- Dizajner setesh dhe shfaqjesh;
- Mësues i punës sociale;
- Sociolog;
- Mësues sociologjive;
- Shkencëtar dheu dhe bimësh;
- Patolog i gjuhës së folur;
- Fizikant mjekësisë sportive;
- Statistician;
- Këshilltar abuzimi me substancat dhe çrregullimit sjelljeje;
- Kirurg;
- Kërkuës sondaresh;
- Planifikues urban dhe rajonal;
- Veteriner;
- Zoolog dhe biolog i jetës së eger

ZONA 4

- Kontabilitetë
- Ekspertë sigurimësh
- Specialistë të Edukimit Fizik
- Mësues dhe lektorë për arsimin e ulët dhe të mesëm
- Menaxherë Reklamimi dhe Promovimi
- Inxhinierë dhe Teknikë Operacionesh për Hapësirën Ajrore
- Inxhinierë të Hapësirës Ajrore
- Agjentë dhe Menaxherë Biznesi për Artistët, Performuesit dhe Atletët
- Inxhinierë bujqësorë
- Pilotë, pilot i dytë dhe Inxhinierë Fluturimësh
- Menaxherë Reklamimi dhe Promovimi
- Vlerësues për Pasuritë e Paluajtshme
- Arkitektë Marine
- Hartues arkitektonikë
- Menaxherë akukulturalë
- Drejtorë të Arteve
- Shkencëtarë për Hapësirën
- Specialistë të Multimediale dhe sektorëve Audio - Vizualë
- Auditorë
- Inxhinierë automobilistikë
- Inxhinierë biokimikë
- Drejtues të prodhimit të Biokarburanteve
- Menaxherë të Teknologjisë dhe Zhvillimit të Karburanteve dhe naftës
- Teknikë bioinformatikë
- Teknikë biologë
- Analistë të Lajmeve për Transmetim
- Specialistë për zhvillimin e tokave
- Menaxherë kimikë
- Kimistë
- Punonjës socialë për fëmijët, familjet dhe shkollat
- Menaxherë civile
- Menaxherë
- Planifikues të vazhdimësisë së biznesit
- Analistë buxheti
- Analistë biznesi
- Mësues/ teknikë të Arsimit Profesional (për Shkollën e Mesme)
- Mësues/ udhëheqës karriere (për Shkollën e mesme)
- Hartografe
- Blerës dhe menaxherë blerjesh të produkteve bujqësore
- Korografe
- Planifikues Rajonal dhe i Qytetit
- Inxhinierë civilë
- Ekzaminues të kërkesave dhe sigurimit të pronës
- Menaxher kompjuteri dhe sistemi informacioni
- Menaxher i të dhënave klinike
- Koordinatorë të Kërkimit Klinik
- Trajnerë
- Projektues industrialë
- Punëtorë shëndetësorë të komunitetit
- Menaxherë për Kompensimet dhe Përfitimet
- Specialistë për Analiza Pune, Kompensimet dhe Përfitimet
- Inxhinierë të pajisjeve kompu-

- terike
- Arkitektë rrjetesh kompjuterike
- Specialistë për mbështetjen e rrjeteve kompjuterike
- Programues kompjuterësh
- Analistë sistemesh kompjuterike
- Inxhinierë/arkitektë sistemesh kompjuterike
- Menaxherë ndërtimi
- Shkrimtarë
- Vlerësues të kostove
- Analistë për kredi
- Këshilltar për kredi
- Teknolog Citogjenetikë
- Administratorë të dhënash IT
- Arkitektë
- Drejtorë, Aktivitetë fetare dhe edukative
- Drejtues, Kinematografia, Televizioni dhe Radioja
- Administratorë e Arsimit, Qendrat Parashkollore dhe Kujdesit për Fëmijë
- Inxhinierë Elektrikë
- Inxhinierë Mjedis
- Inxhinierë elektro-teknikë
- Inxhinierë elektronikë, përveç kompjuterit
- Mësues të shkollave fillore, përveç arsimit special
- Drejtorët e Menaxhimit të Emergjencave
- Brokeratë e Energjisë
- Inxhinierët e Energjisë
- Inspektorët e Mbrojtjes së Mjedisit
- Teknikët e Inxhinierisë së Mjedisit
- Teknikët e Shkencës dhe Mbrojtjes së Mjedisit
- Shkencëtarët e mjedisit dhe specialistët, duke përfshirë shëndetin
- Përfaqësuesit dhe Zyrtarët e Shansëve të Barabarta
- Fermierët dhe Menaxherët e fermave
- Analistë financiarë
- Ekzaminues financiar
- Menaxherët financiar, degët ose departamentet
- Inxhinierët e Parandalimit të Zjarrit dhe Mbrojtjes
- Mbiqëqësorit e linjës së parë të punonjësve të akuakulturës
- Mbiqëqësorit e linjës së parë të punonjësve të shpërthimit me pakicë
- Notar dhe roje bregdetar
- Koordinator Fitness dhe Wellness
- Shkencëtar dhe teknolog ushqimor
- Teknikë të Shkencave Ligjore
- Rojtar pylli
- Muzikant
- Administrator rrjeti kompjuterik
- Specialist shëndetësie
- Tregtar online
- Këshilltar financiar
- Inxhinier naftë
- Poet
- Drejtues programi
- Prodhues
- Administrator pronash
- Menaxher PR
- Drejtues televizion e radiofonik

- Terapist
- Agjent shitjesh
- Inxhinier shitjesh
- Përfaqësues shitjesh
- Strateg marketingu dhe kërkimi
- Tregtues aksionesh dhe lëndësh të para
- Menaxher sigurie
- Asistent social
- Kërkuës shkëncor
- Programues
- Mësues
- Magazininier
- Drejtues talentesh
- Drejtues teknik
- Inxhinier transporti
- Menaxher trajnimi dhe zhvillimi
- Inxhinier energjie nga era
- Zbuluesit e mashtimit, hetuesit dhe analistët
- Inspektorët e ngarkesave
- Drejtuesit e Përgjithshëm dhe Operacioneve
- Topograf Gjeodezike
- Teknikët e Sistemeve të Informacionit Gjeografik
- Teknikët e testimit të mostrave gjeologjike
- Teknikë Gjeofizikë të të Dhënave
- Gjeologë, përveç hidrologëve dhe gjeografëve
- Shkencëtarët gjeohapsinorë
- Grafik dizajnerë
- Edukatorët e Shëndetit
- Menaxherët e Burimeve Njerëzore
- Specialistët e Burimeve Njerëzore
- Hidrologë
- Teknologë të Inxhinierisë Industriale
- Inxhinierë Industriale
- Menaxherët e Prodhimit Industrial
- Inxhinierët e sigurisë industriale dhe të shëndetit
- Specialistë për Infermierinë Informatike
- Analistët e Sigurisë së Informacionit
- Menaxherët e Projekteve të Teknologjisë së Informacionit
- Agjentët e shpërthimit të sigurimeve
- Siguruesit e Sigurimeve
- Analistë të Intelligjencës
- Projektues të Brendshëm
- Përkthyesit
- Mësues të kopshit
- Specialistët e marrëdhënieve të punës
- Arkitektë Peizazhi
- Ligjvënësit
- Këshilltarët e Huasë
- Menaxherët e Strehimit
- Logjistë
- Analistët e Logjistikës
- Inxhinierët e Logjistikës
- Menaxherët e Logjistikës
- Menaxherët e Parandalimit të Humbjeve
- Teknologjët e Inxhinierisë së Prodhimit
- Inxhinierët e Prodhimit të Arkitekt detar
- Inxhinierët Detare
- Analistët e Kërkimeve të Tregut dhe Specialistët e Marketingut

- Menaxherët e Marketingut
- Inxhinierët e materialeve
- Teknikë matematikorë
- Inxhinierët Mekanike
- Inxhinierët e mekanikes
- Laboratorë të Teknologjisë Mjekësore dhe Klinike
- Planifikues i eventeve, Takimi, konventa
- Mësuesit e shkollave të mesme, me përfaqësim të arsimit profesional
- Mamitë
- Inxhinierët e Minierave dhe Gjeologjike, përfshirë Inxhinierët e Sigurisë në Miniera
- Artistë dhe animatorë multimediale
- Teknikë dhe Konservatorë të Muzeut
- Dirigjentë

ZONA 5

- Akupunkturistë
- Gjakatës ligjesh administrative;
- Infermiere të praktikave të avancuara psikiatrike;
- Mësues shkencash agrokulturore;
- Alergolog dhe imunologj;
- Asistentë anesteziologjist;
- Shkencëtar kafshësh;
- Antropolog;
- Mësues antropologjive dhe arkeologjive;
- Arbitra, ndërmjetës;
- Arkeolog;
- Menaxherë arkitekturorë dhe inxhinierë;
- Mësues arkitekture;
- Arkivist;
- Mësues studimesh etnike dhe kulturore;
- Terapist arti;
- Mësues arti, drame dhe muzike;
- Astronom;
- Trajnerë atletikë;
- Mësues shkencash atmosferike, tokësore, detare dhe shkencore;
- Audiolog;
- Biokimist dhe biofizikant;
- Shkencëtarë bioinformatike;
- Mësues shkencash biologjive;
- Biolog;
- Biostatistician;
- Mësues biznesi;
- Mësues kimie;
- Drejtues ekzekutiv;
- Kriogjigant;
- Klegjia;
- Analist i ndryshimeve klimatike;
- Infermiere specialiste klinike;
- Psikolog klinike;
- Mësues komunikimi;
- Shkencëtar kompjuterësh dhe informacioni;
- Mësues shkencash kompjuterike;
- Psikolog këshillues;
- Mësues i zbatimit të ligjit dhe të drejtës penale;
- Kuratorë;
- Citoteknolog;
- Dentist;
- Dermatolog;
- Dietist dhe nutrolog;
- Mësues ekonomie;

- Ekonomist;
- Administratorë edukimi;
- Mësues edukimi;
- Këshillues shkollorë;
- Mësues inxhinierë;
- Mësues i gjuhës angleze dhe letërsisë angleze;
- Ekonomist mjedisor;
- Inxhinier mjedisor;
- Planifikues ripërtëritjeje mjedisore;
- Mësues shkencash mjedisore;
- Epidemiolog;
- Fiziolog ushtrimesh;
- Këshilltar menaxhimi shtëpie dhe ferme;
- Analist financiar kuantitativ;
- Mësues gjuhë të huaj;
- Mësues pylltarë;
- Inxhinier qelizash karburanti;
- Gjenetist;
- Gjeograf;
- Mësues gjeografje;
- Punonjës të shëndetit social;
- Historian;
- Mësues historiel
- Mësues ekonomie shtëpiake;
- Ekologjist industrial;
- Menaxher fond investimi;
- Gjakatës, magjistratë;
- Mësues ligjesh;
- Avokat;
- Libranist;
- Terapist martesash dhe familjesh;
- Shkencëtar materialesh;
- Mësues shkencash matematike;
- Matematician;
- Menaxher shërbimesh mjekësore dhe të shëndetit;
- Punonës i shëndetit mendor dhe abuzimit me substancat;
- Këshilltar i shëndetit mendor;
- Mikrobiolog;
- Inxhinier mikrosistemesh;
- Biolog molekular dhe qelizor;
- Inxhinier nanosistemesh;
- Menaxher i shkencave të natyrës;
- Fizikant natyropatik;
- Neurolog;
- Neuropsikolog;
- Fizikant i mjekësisë nukleare;
- Infermiere anestezieste;
- Infermiere;
- Mësues dhe instruktore infermiere;
- Gjinolog dhe obstetrist;
- Terapist punësimit
- Oftalmolog;
- Optometrist;
- Kirurg oral dhe maksiofacial;
- Ortodontist;
- Patolog;
- Pediatër;
- Farmacist;
- Mësues filozofie dhe teologjie;
- Terapist fizikant;
- Asistent fizikant;
- Mësues fizikant;
- Mësues shkencash politike;
- Shkencëtar politikë;
- Fizikant i mjekësisë parandaluese;
- Psikiatër;
- Mësues psikologjijë
- Radiolog;

HOMAZHET

Robert Elsie

Ceremoni lamtumire me lahutë te kisha e Thethit

Fatmira Nikolli

Partneri dhe Metani: Pse zgjodhëm Alpet për amanetin e tij

Robert Elsie mbërriti dje për herë të fundit në Shqipëri. Është tashmë një ardhje pa kthim dhe udhëtimi i tij i mbramë. Trupi i pajetë i albanologut në zë, mbërriti në aeroport rreth orës 11:00 pas një sërë letërkëmbimesh mes partnerit të Elsiës Stephan Trierweiler dhe mikut të tij prej 25 vitesh, Artur Metanit, me ambasadën shqiptare në Berlin e Ministrinë e Jashtme. Ka qenë "dragomani" i tij, Metani, ai që e ka shoqëruar në çdo udhëtim anë e kënd Shqipërisë e tokave të saj mbetura jashtë shtetit zyrtar, ai që e ka përcjellë nga Berlini në Tiranë dhe më pas e ka pritur në Tiranë për ta drejtuar makinën si gjithnjë drejt rrugëve të Elsiës, por tashmë për të fundit herë. Në makinën që mbante arkëmortin, ku shtrohej trupi i pajetë i veshur me kostum shqiptar, Metani e drejtoi në "guidën" e fundit, nga Rinasi për në Bibliotekën Kombëtare ku u mbajtën homazhet dhe prej aty për në Shkodër e mandej në Theth, ku ai do të prehet, pranë kishës së fshatit, këtë të mërkurë.

HOMAZHET

Presidenti Ilir Meta, ministri i Jashtëm Dritmir Bushati, ministria e Kulturës, Mirela Kumbaro, ish-kryeministri Sali Berisha, ish-ministri Aldo Bumçi, kreu i opozitës Lulzim Basha, akademikë shqiptarë si Shaban Sinani e Vasil Tole, akademikë nga Kosova si Rexhep Ismajli, profesorë të Fakultetit të Tiranës, studiues, miq, dashamirës, admirues, janë falur me albanologun teksa kanë ardhur ta nderojnë në homazhet e mbajtura pranë Bibliotekës Kombëtare. Një kurorë lulesh u soll edhe nga kryeministria në emër të kreut të qeverisë, Edi Rama.

Pas homazheve, partneri i Elsiës, Stefan Trierweiler ka saktësuar se dëshira e albanologut ka qenë të prehet në Shqipëri, ndër-asa vetë ai, zgjodhi Thethin. Stephan Trierweiler tha se të mos ishte për Metanin, që është angazhuar për mbajtjen e ceremonialeve në Shqipëri do të ishte e pamundur. "Thethi nuk ka qenë zgjedhje e vetë Elsiës, por ai në të gjallë ma la mua në dorë vendin e prehes. Zgjedha Thethin, si një vend shumë i dashur për të si studiues", - tha partneri i jetës së Elsiës.

Nga ana tjetër, gjuhëtari kosovar Rexhep Ismajli i njohu meritat si një ndër albanologët e huaj që e bëri të njohur kulturën shqiptare në rrafshin evropian të studimeve, duke qëmtuar e përkthyer në an-



Lafe bëri me dije se së fundmi bashkë me Elsiënë kishin në dorë dorëshkrimin e Simon Kazanxhiut, dorëshkrim i vitit 1820. E njohur si Fletorja e Simonit (Kazanxhiut) është një fletore shënimesh e shkruar me alfabetin e Dhaskal Todrit.

glisht e gjermanisht materiale për letërsinë, fotografinë, etnografinë dhe historinë shqiptare. "Albanolog i shkathët e i mirëformuar. Ka qenë zë e dritare për kulturën shqiptare kur zëri jonë nuk ishte i pranishëm, e kam pasur mik familjeje. Ai u dashurua me Shqipërinë sa u bë një ndër miqtë më të mëdhenj. E rëndësishme ishte përhapja e kulturës shqiptare dhe informacionin. Ka qenë i pranishëm në qarqe europiane me shërbimin e ndërmjetësimin e tij. Ka pasur shumë dyer të hapura e na ka ndihmuar. Dy fjalorët që ka bërë për Shqipërinë e Kosovën, Historinë

e letërsisë e ka bërë me një vizion tjetër. Ka pasur rol të madh në përkthim sidomos ato në anglisht apo edhe atë të Lahutës", tha Ismajli.

Përfaqësuesi i komunitetit të Thethit, Zef Bari, tha para mediaeve se ceremonia mortore në Theth do të ketë mes të tjerash edhe këngë me lahutë që sipas tij, vetë Elsie e ka dashur: "Ka kërkuar që të ketë një ceremoni me këngë me lahutë. Ne e kemi pasur traditë t'i varrosim me kostume kombëtare, e përveç kësaj ka kërkuar që të përcillet me një këngë me lahutë. Gjama nuk bëhet, sepse nuk e ka



Në rreth: Miku i Elsie, Artur Metani dhe partneri i tij Stephan Trierweiler

Emil Lafe: Vepra e fundit për Simon Kazanxhiun e alfabetin e Todrit



Robert Elsie

kërkuar edhe, sepse nuk e bëjmë dot aq mirë sa bëhej dikur. Duhej të ishin rreth 50 burra. Ai me sa duket e ka menduar se kjo ishte shumë e rëndë dhe shumë e trishtë", - tha Bari.

Robert Elsie u nda nga jeta në moshën 67-vjeçare në datën 2 tetor për shkak të një sëmundjeje të rëndë, të cilën ai e zbuloi vetëm pak muaj më parë, por që ishte vdekjeprurëse duke bërë që ai të shuhej vetëm në pak kohë nga diagnostifikimi i saj. Miku i shqiptarëve, që ka punuar fort për nxjerrjen e fakteve të reja për historinë dhe gjuhën shqipe do të prehet me kostum popullor të zonës së Thethit pranë kishës së vogël.

FLETORJA E KAZANXHIUT

Gjuhëtari i njohur Emil Lafe, i cili ka pasur njohje e kontakte me Elsiënë që në komunikim përmes letërkëmbimeve, bëri me dije se ai do merret me botimin e veprës së fundit të albanologut që do të dalë në dritë në dhjetor.

Lafe bëri me dije se së fundmi bashkë me Elsiënë kishin në dorë dorëshkrimin e Simon Kazanxhiut, dorëshkrim i vitit 1820.

E njohur si Fletorja e Simonit (Kazanxhiut) është një fletore shënimesh e shkruar me alfabetin e Dhaskal Todrit. Robert Elsie e ka transkriptuar; bazuar në transliterimin e Qemal Haxhihasanit të vitit 1948-1949. Fletorja përmban shënime të ndryshme për lindje e vdekje në lagjen kala, shënime mbi

ushqime e mbi kura për sëmundje si edhe fjalorët italisht-shqip, e polonisht-shqip.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka njoftuar se në Theth do të organizohet një ceremoni e veçantë para varrimit, ditën e mërkurë, 18 tetor 2017, në orën 14.00, në nder të përkushtimit dhe dedikimit që ai pati ndaj vendit tonë, traditave dhe gjuhës sonë amtare duke lartësuar vlerat, kulturën dhe identitetin tonë kombëtar.

PUNA QË LA

I qetë, i qeshur, i urtë, i pazë, modest e timid, pa rrahur gjoksin, larg skenave e projektoreve, fjalë-pakë e punëshumë, qëntoi për vite të gjata dëshmi të kulturës shqipe, në biblioteka e arkiva, anekënd botës. Me durimin e kërkimit të një gjilpërë në kashën e madhe, mbloodhi dëshmi të shqipes së shkruar e të folur, të historisë e fotografisë, të letërsisë e rrëfimeve, duke hedhur dritë mbi historinë e vendit tonë, që u bë i tij, falë një ngulmimi të pashtershëm për të nxjerrë në dritë gjithë çfarë shekujt kishin mbuluar e fshetur. U bë zëdhënës i kësaj kulture që strukej në një gjuhë të bukur, por të vështirë e të panjohur - i dha zë duke e përkthyer në anglisht e gjermanisht që të kishte qasjen e gjithë botës. Vendosi të ikë në heshtje, pa marrë keqardhjen e askujt. Vuajti pak muaj, derisa në fillim të muajit Robert Elsie bëri gjëmën e madhe, duke u ndarë nga jeta papritur, kaq shpejt, krejt pabesisht e para kohe e duke lënë bosh një vend të rëndësishëm e tërë-sisht të pazvëndësueshëm. Bëri i vetëm e pa buxhete më shumë se ç'kanë bërë disa titullarë me fonde të majme. Ai burrë që ikën, ai burrë që na ktheu shpinën, për gjithë ç'ka bërë na ka prerë krahët, duke na lënë pothuaj "jetimë". Pati qarë kur në Hagë përkthente në gjyq krimet e serbëve në Kosovë, mandej me të folmen me dialekt Kosovar, udhëtoi, incizoi e pra dokumentoi e dha dëshmi të pakontestueshme për Kosovën, Shqipërinë, copëzat e Shqipërisë të mbetura jashtë kujfjës, për arbëreshë e arvanitë, për çamë e arbëreshë të Zarës.

Lista emërore në Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë. Kompensimi fizik e financiar, në rend kronologjik

ATP, statusi i secilës pronë në Shkodër

Emrat e pronarëve, sipërfaqja e pretenduar dhe sa kompensohet

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtitimit të Pronës ka përditësuar regjistrin e saj elektronik për dosjet e pronave në të gjithë vendin. Çdo trashëgimtar pronash ka mundësi të lexojë në "Gazetën Shqiptare" statusin e dosjes së tij dhe problematikën e dokumenteve që mund të ketë secili pronar. Regjistri elektronik mban të

dhëna të detajuara për çdo aplikim dhe çdo proces që ka ndodhur me pronat që nga viti 1993 dhe deri tani për qarkun e Shkodër. Secila nga dosjet përmban emrin e subjektit të shpronësuar si dhe emrin e subjekteve që e pretendojnë atë pronë. Në dosje pasqyrohen sipërfaqja e pretenduar si dhe lloji i pasurisë, sipërfaqja e njohur, sipërfaqja e kthyer apo e kompensuar. Ndërkohë që pasqyrohen edhe të gjitha vendimet e Komisioneve dhe Zyrave Rajo-

nale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për secilin subjekt, bashkë me vendimet gjyqësore dhe problematikën e secilës dosje. "Gazeta Shqiptare" nis sot publikimin e pjesës së katërbëdhjetë të listës së veprimeve që janë kryer me dosjet e pronave të qarkut të Shkodër. Të gjithë të interesuarit njihen gjithashtu edhe me problematikën që mund të ketë dosja e tyre, siç është mungesa e dokumenteve të caktuara. Ndërkohë, Agjencia e Tra-

jtitimit të Pronave ka marrë në shqyrtim dosjet në qarkun e Elbasanit, të cilat janë në proces shqyrtimi. Regjistri i dosjeve në shqyrtim pasqyron numrin e dosjes, emrin e subjektit të shpronësuar, kërkuesin, llojin e pasurisë si dhe të dhënat në lidhje me sipërfaqen e njohur, sipërfaqen e kthyer dhe sipërfaqen e kompensuar. Në regjistër janë edhe të dhënat për çdo dosje për vendimet e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe prob-

lematika që ka çdo dosje, e cila pasqyron mangësinë në dokumentacion. Sot publikohet regjistri elektronik i pronave në qarkun e Shkodër, ku përfshihen Shkodra, Malësia e Madhe dhe Puka. Dosjet ndodhen në Agjencinë e Trajtitimit të Pronave në proces shqyrtimi dhe do të trajtohen me ligjin e ri. Vendimi do të merret sipas rendit kronologjik të kërkesave dhe kompensimi do të shpërndahet sipas këtij rendi, me përjashtim të rasteve

kur subjekti kërkon të përfitojë nga pagesa e përshpejtuar, ose kërkon të jetë pjesë e tenderit për kompensimin fizik në bazë të pronave që ka vënë në dispozicion ATP-ja. ATP-ja do t'i japë përparësi kompensimit të trullit. Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe vendimi do të merret sipas rendit kronologjik të kërkesave dhe kompensimi do të shpërndahet sipas këtij rendi, me përjashtim të rasteve

LISTA E VEPRIMEVE QË JANË KRYER ME DOSJET E PRONAVE TË QARKUT TË SHKODRËS (PJESA E KATËRMBËDHJETË)

(Vijon nga numri i djeshëm)

Emri (Subjekti i shpronësuar)	Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri (Subjekti Kërkues)	Mbiemri (Subjekti Kërkues)	Sip. E pretenduar, m2 & lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	NR I Vendimit I KKKP, ZRKKP	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Sip. E Kompensuar M2	Problematika	Emri (Subjekti i shpronësuar)	Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri (Subjekti Kërkues)	Mbiemri (Subjekti Kërkues)	Sip. E pretenduar, m2 & lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	NR I Vendimit I KKKP, ZRKKP	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Sip. E Kompensuar M2	Problematika
Shaban	Brahiri	Nexhip	Mehmeti	1500m2 truall	Fshati Pacram Hajmel / 2851	319	1500	1500	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua	Kishat e Planit dhe Kirit		Kisha Franceska		10000m2 truall	fshati Plan e Kir Komuna Pult/ 2151	311	10000		Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Mustaf	Llukaj	Mustaf	Llukaj	5000m2 truall	Guc e Re / 1880	318	1300	1300	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua	Provincia Franceska ne per Kishat e Dishmanit dhe Topalane s		Provincia Franceska ne per Kishat e Nicaj-Shale Prekal	Nicaj-Shale	5500m2 truall	Nicaj-Shale Prekal / 2791	312	6760		Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Kisha Abat, Theth, Gimaj		Kisha Abat Theth		4400m2 truall 7000m2 truall 424m2 truall	Gimaj / 1714	317	11824	424	Ka vert.pronesie Ka vert.kadastral Vendimi nuk u ankimua	Pashko ; Matilde	Coba	Pjeter	Coba	38500m2 truall	Berdice e Poshtme / 1157	429	13450	1350	Sip=600m2 i kthehet ish-pronarit
Latif	Alija	Mefit	Alija	9700m2 truall	Golem / 1790	316	9700		Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua	Llesh	Brunga	Llesh	Brunga	1550m2 truall	Gomsiqe / 1799	428	1550	350	
Hysen	Hyseni	Halit	Hyseni	10900m2 truall	Bushat / 1329	315	10900	10900	Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua	Lek	Nika	Lek	Nika	1000m2 truall	Koman / 2290	427	1000	1000	Pronesia vertetohe t nga Vertetimi i pronesie leshuar nga Keshilli I Rrethit Shkoder
Prek	Dedaj(Stakaj)	Pjeter	Dedaj	1000m2 truall	Velipoje / 3734	314	1000	1000	Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua	Mejreme ; Mustafa	Lahi	Hajrullah	Lahi	36 dy	Shtoj i Ri / 3428	426	200		Pronesia vertetohe t nga Vertetimi i pronesie leshuar nga Zyra e Ipotekes Shkoder
Mark	Pjetri	Gasper	Kuqani	10000m2 truall	Baks-Rrojle / 1076	313	10000	2900	Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua					S1=220m2 S2=1500m2	Rranxa / 3205	425	1720	1500	Pronesia vertetohe t nga Vertetimi i pronesie leshuar nga Zyra e Ipotekes Shkoder
Provincia Franceska ne per Kishat e Dishmanit dhe Topalane s		Provincia Franceska ne per Kishat e Dishmanit dhe Topalane s	Dishmanit	6500m2 truall 3500m2	Kishe Shllak	310	10000		Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua	Hamdi ; Ganxhe	Bushati	Trashg. Bushati							

(Vijon nesër)

Mirianne Johnson e Universitetit të Manchester do të jetë pjesë e stafit akademik

Universiteti "Luarasi" nis vitin e ri akademik, studentët: Projektim i sigurt i të ardhmes sonë

Mbi 80% e të diplomuarve të "Luarasi" gjejnë një vend pune

NGA AURORA GOLEMI

TIRANË- Kolegji Universitar "Luarasi" nisi vitin e ri akademik. Për studentët e rinj, "Luarasi" mbetet zgjedhja më e mirë, çka do të thotë një hap më pranë ëndrrave dhe projektimit i sigurt i së ardhmes së tyre.

"Luarasi" e nis vitin e ri akademik me vulën e besueshmërisë, i certifikuar nga autoritetet shqiptare dhe ekspertiza britanike për funksionimin e tij institucional. Sipas rektorit të Kolegjit Universitar "Luarasi", Arben Malaj, studentët janë partnerët e suksesit.

Stafi akademik organizoi një takim mirëseardhje në këtë fillimviti të ri akademik për studentët që vijnë për herë të parë në auditorët e tij, por edhe ata që ndër vite i besuan.

Rektori i "Luarasit", profesor Arben Malaj, i garantoj se me diplomën e "Luarasit" studentët do ta kenë të lehtë depërtimin në tregun e punës, pasi në auditorë do të mësohet edhe duke punuar pranë bizneseve. "Luarasi" bashkëpunon me institucione publike dhe private, zyra e karrierës është ura lidhëse për studentët.

Për dekanët e Fakultetit të Drejtësisë dhe të Ekonomisë, ky universitet nuk ofron vetëm auditorë ku mësohet, por edhe një eksperiencë unike me profil evropian, që finalizohet me një diplomë të



vyer në tregun e punës. Shifrat flasin vetë, mbi 80% e studentëve që diplomohen të "Luarasi" gjejnë një vend pune.

Ky vit i ri akademik të "Luarasi" karakterizohet nga disa risi dhe me një numër akoma më të madh partnerësh akademikë të huaj. Krerët e "Luarasit" bënë me dije se programe të reja janë shtuar në këtë vit akademik.

"Luarasi" do të ketë një program të përbashkët me Universite-

tin e Tennis në SHBA për degën Financë, si dhe do të hapë kursin e parë për luftën kundër korrupsionit në politikë.

Sakaq, profesore Mirianne Johnson e Universitetit të Manchester, e financuar nga qeveria amerikane nëpërmjet programit "Fullbright", do të jetë pjesë e stafit akademik në Fakultetin e Ekonomisë. "Jam shumë e lumtur që jam këtu. Programi "Fullbright" është një pro-

gram i shkëlqyer që financohet nga qeveria amerikane. Jo vetëm stafi akademik, por edhe studentët mund të aplikojnë për të studiuar në Shtetet e Bashkuara gjatë këtij viti akademik. Shumë shqiptarë do kenë mundësinë të jenë pjesë e këtij programi prestigjioz, një ndër më të mëdhenjtë për shkëmbimin e studentëve dhe pedagogëve në botë", tha Johnson.

Për të motivuar studentët, ka folur para auditorit edhe Kennan

Burch, ekspert në fushën e marketingut dhe mentor i disa kompanive globale.

"Këtë vit do të sfidoheni. Ju inkurajoj të ndërmerrni risqe dhe të sfidoni veten. Edhe në rast se dështoni është një leksion, çohuni dhe merrni më shumë iniciativë të reja. Më thanë se ju jeni vendi i shqiptarëve. Ju inkurajoj që të besoni se jeni shqiptarë. Rrini me njëri-tjetër që ua thonë këtë. Në rast se ju thonë që nuk do ia dilni apo që nuk do t'i realizoni ëndrrat, mos u shoqëroni më me këta njerëz. Ju mund ta bëni ndryshimin nëse besoni te vetja juaj", tha Burch.

Fondacioni amerikano-shqiptar, gjithashtu, do të mbështesë "Luarasin" këtë vit të ri akademik në lidhje me tekstet mësimore, si dhe me mënyrën e vlerësimit të arrijtjeve të studentëve ndërmjet një softueri të veçantë, risi në sistemin arsimor shqiptar.

Emocionet e një viti të ri akademik më së shumti i përjetojnë studentët e vitit të parë. Arsyet se përse kanë zgjedhur "Luarasin" janë nga më të ndryshmet. Emri i "Luarasit", për ta është garanci. "Luarasi" plotëson të gjithë tablonë e asaj çka duhet vërtet të ofrojë një universitet, që, mbi të gjitha, synon të mbajë lart emrin e vet dhe që i drejtohet atij segmenti të studentëve, të cilët duan një arsimim elitare, e që kërkojnë të kenë vëmendje gjatë kohës së formimit të tyre.

Te gjitha te rejat nga jeta ipave

BLUE TOOTH

THASHETHEME MADE IN ALBANIA

Gazetë e shtunë falas me GAZETA SHQIPTARE

Opinioni **i Ditës**

Nga Bujar Nishani

(vijon nga faqja 1)

... ku brenda territorit të vet administrativ jetojnë (afërsisht) vetëm 40% e popullsisë që i takojnë kombësisë përkatëse (shqiptare).

Veç popullsisë shqiptare, që jeton në trojet e veta etnike në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e Luginë të Preshevës, shqiptarët kanë një diasporë të madhe të përhapur në vende të ndryshme evropiane, USA, Kanada, Australi, por dhe vende të tjera. Një diasporë e krijuar nga gjenerata të ndryshme emigrantësh përfshirë ata politikë dhe ekonomikë. Janë disa miliona këta që kanë ndërtuar jetën atje në breza, por duke ruajtur identitetin e tyre kombëtar dhe duke krijuar njëkohësisht një thesar të kapitalit njerëzor dhe atij ekonomik e financiar. Kapacitetet e saj, por dhe energjitë janë të shumta dhe për fat të keq të injorura dhe të pa shfrytëzuara. Retorika vijon dhe nuk po ia lë vendin përgjegjëshmërisë dhe angazhimeve konkrete. Shqipëria prej kohësh e ka pasur të nevojshme një institucion në nivel ministrie për diasporën. Mund të mungojë vullneti për ta krijuar dhe kjo është keq, por të pretendosh se po merresh me diasporën duke emëruar një ministër pa portofol është të tallsh me atë dhe kjo është shumë keq! Samiti i ashtuquajtur i diasporës në nëntor 2016 u shndërrua në një show partizan pa kurrfarë produkti. Kush mund të thotë sot, pas një viti, në prag të samitit të dytë se çfarë ka prodhuar apo ndodhur në një vit prej atij samiti. Pa dyshim është e nevojshme që të ketë edhe Kuvend të diasporës, ku minimalja të prodhohet senati i saj dhe platforma e angazhimeve konkrete. Pas atij samiti, buxheti i ri i vitit që u miratua vetëm një muaj më pas nuk parashikoi asnjë qindarkë për çështjet e diasporës. Në SHBA diaspora shqiptare ka njohur një

Të paktën të mos e fyejmë diasporën!



rritje të jashtëzakonshme numerike, por dhe cilësore si potencial. Kam pasur rastin të shoh nga afër dinamikën e "Vatrës", një organizatë patriotike prej gjeneratash të shumta, e cila ende ruan këtë ndërthurje brezash, APEN, modeli i përbashkimit të identitetit kombëtar me hapësirën e mundësive që të jep ëndrra amerikane, Albanian Excellence, një bashkim i jashtëzakonshëm vlerash të grave dhe vajzave të talentuara shqiptare. Pa numëruar këtu një mori organizatash aktive në New York, Michigan (si shtet), Çikago, Florida (si shtet), Boston, etj. Askush prej pjesëtarëve të tyre nuk është ftuar të jetësojë eksperiencën dhe dijet në administratën

publike shqiptare. Forumi Ekonomik Mbarëkombëtar i mbajtur në NY në shtator 2016 mbledhi me qindra biznesmenë të suksesshëm shqiptarë nga diaspora. Askush prej tyre nuk ka gjetur derën hapur për incentiva investuese në Shqipëri. Shoqata e mjekëve shqiptaro-amerikan, një bashkim i mjekëve të shkëlqyer në USA ju vu në dispozicion zyrtarisht qeverisë shqiptare për të shërbyer me turne mujore në spitalet e Shqipërisë si në menaxhim të tyre ashtu dhe ushtrinë profesionale, pa asnjë pagesë. U injoruan totalisht! Artikulimi i vlerave të diasporës dhe i investimit të shtetit shqiptar vetëm të mundësimi i votimit për emigrantët është shumë larg sen-

sit të përgjegjësisë dhe dëshirës për angazhim. Votimi nga emigrantët është një çështje e rëndësishme dhe duhet zgjidhur sa më parë. Por që të bëhet i realizueshëm, duhet të shohim së pari, largimin e grupeve kriminale nga blerja e votave dhe përfundimin e infrastrukturës së votimit elektronik. Por dimensionin i diasporës është shumë më i madh. Janë me miliona që nuk e kanë nënshtrësinë shqiptare e ata nuk janë aset votuesish. A më thotë dot kush nga qeveria shqiptare se ku është çelur një qendër kulturore shqiptare? Në New York nga autoritetet vendore me mbështetjen e Asamblestit Mark Gjonaj u mundësua dhënia e një objekti për Qendrën Kulturore Shqiptare. Por duhej një investim fillestar më pas për të. Asnjë qindarkë deri më sot nuk është vendosur nga qeveria. Janë me mijëra mësues vullnetar që u mësojnë gjuhën shqipe fëmijëve të diasporës në Amerikë, Itali, Greqi, Zvicër e deri në Kanada e Australinë e largët. Më thotë dot kush nga qeveria shqiptare, a ka një fond shtetëror për financimin e tyre dhe bazës shkollore? Jo, sigurisht asgjë. Mund të mungojë dëshira dhe angazhimi për t'i shërbyer diasporës, mund të mos jesh i aftë dhe i zoti t'i kthesohet potencialet e saj në asete edhe për vendin e origjinës, por është krejt e papranueshme të fytet ajo duke e përdorur si subjekt i shout politik. Në këtë showbiz mund të marrë pjesë çdokush që dëshiron, por unë nuk shoh asnjë arsye që opozita shqiptare të bëhet skenografia e tij. Përtej gjithë kësaj përpjekjeje pa produkt, diaspora mbetet resurs i jashtëzakonshëm. Ajo pret.....

Komentit **Sportiv**

Nga Ervin Baku

(vijon nga faqja 1)

... për të gjithë shqiptarët, pasi përballë korçarëve do të jetë një skuadër serbe. Në "Elbasan Arena" nuk do të ketë asnjë tifoz serb. Dhe më 2 nëntor, në Beograd, nuk do të ketë asnjë tifoz shqiptar. UEFA vendosi përjashtimin e tifozëve (serbë në Elbasan dhe shqiptarë në Beograd) sepse kjo ndeshje na qenka e një rrezikshmërie shumë të lartë. Ky është një autogol i pastër i UEFA-s. Futbolli bashkon njerëzit. Futbolli bashkon popujt. Dhe UEFA, organizatorja e eventit, në vend që të ndërtojë ura bashkëpunimi dhe miqësie, gjeti dhe bëri gjënë më të lehtë, vendosi kufijtë. Unë e kuptoj shumë mirë që futbolli është minuar nga politika, por futbolli kurrse nuk mund dhe nuk du-

het të minohet nga vetë futbolli. Përderisa e lejuan shortin dhe përballjen e këtyre dy skuadrave dhe bënë gjënë më të mirë të mundshme, UEFA duhet t'i shkente deri në fund misionit të saj. Të promovonte ndërtimin e urave të miqësisë dhe bashkëpunimit mes popujve. Të promovonte një klimë të re në marrëdhëniet shqiptaro-serbe. Gjithmonë brenda kontekstit të një ndeshjeje futbollit. A e mbajnë gjallë futbollin tifozët? Patjetër që po. A mund të luhet futbollit pa tifozë? Jo, kurrë. Atëherë me ç'të drejtë pengohen serbët të vijnë në Shqipëri dhe shqiptarët të shkojnë në Beograd? Një ndeshje futbollit duhet të jetë një festë e vërtetë. Dhe jo



një siklet i madh. Dhe UEFA vazhdon ta mbrojë sikletin përmes barrierave të pakuptimita. Edhe fu-

tbollisti ynë Jashanica ra në "grackë" kur deklaroi se "ndeshja kundër Partizanit të Beogradit natyrisht që do të jetë e veçantë. Të gjithë e mbajnë mend ende se çfarë kanë bërë serbët në Kosovë". Jo, miku im Bajram, duhet ta shikosh thjesht dhe vetëm si një ndeshje futbollit. E veçanta e kësaj sfide duhet të qëndrojë vetëm në faktin e rëndësisë së kualifikimit për më tej në Ligën e Europës... Shqiptarët dhe serbët janë të destinuar të bashkëjetojnë në këto toka që jemi sot. Asnjë prej dy popujve nuk do transferohen në hënë. Atëherë le ta bëjmë këtë bashkëjetesë me respekt reciprok. Futbollistët dhe tifozët mund ta bëjnë këtë fare mirë.

HOROSKOPI

DASHI
Bashkëveprimi i Hënës me Venusin do të bëjë që sot të kaloni një ditë të shumë bukur dhe të frytshme. Gjithçka do t'ju duket e thjeshtë. Do të keni harmoni edhe në fushën e dashurisë. Është dita ideale për të kaluar kohën me miqtë ose me familjen. Përfiton!

DEMI
Për shkak të ndikimit jo të favorshëm të Uranit, nuk duhet të humbni nëpër hollësi, por duhet të përqendrohuni në esencën e gjërave. Organizohuni! Vazhdon lëvizja vrytuese e Jupiterit, e cila premon ndryshime pozitive dhe krijuese në jetë.

BINJAKET
Ditën e sotme, pasiguria dhe xhelozia në çft mund të shfaqen në formën e grindjeve. Me Venusin që ju mbështet, nëse punoni në fushën e artit ose spektakleve, parashikohen rezultate që ju përmbushin shpirtërisht dhe ju kënaqin nga ana materiale.

GAFORJA
Tensionet e lidhura me probleme profesionale do të lehtësohen vetëm nga ëmbësllia e personit të zemrës, që sot do të jetë më e theksuar. Nuk ndiheni të qetë brenda vetes, sepse nuk arrini të zgjidhni midis dy pretendentësh që ju kanë magjepsur.

LUANI
Për merit të Hënës dhe Jupiterit, sot do t'ia dini të përgatiteni në mënyrë efektive për të ndjekur objektivat me vendosmëri. Bisedoni me partnerin, mund të keni mbetur disi të ndarë nga njëri-tjetri nga zgjedhjet tuaj të fundit. Jini të kuptueshëm!

VIRGJERESHA
Nuk është e habitshme që të jeni disi nervoz! Më Hënën që ju shqetëson, ju duket se çdo gjë shkon keq. Në fakt, gjërat po shkojnë shumë mirë. Rini me njerëz me të cilët kuptoheni dhe shmangni ata që parajgjykojnë këdo dhe gjithçka.

PESHORJA
Falë Plutonit aleat dhe Saturnit bashkëpunues, dhunitë tuaja intelektuale do të shkëlqejnë për t'ju çuar përpara. Shmangni një mik të pavendosur. Me ndihmën e Saturnit, do të dini, ditë pas dite, të ndërtoni atë që keni për zemër.

AKREPI
Do të keni një dëshirë të fortë për të bërë të lëvizë rutinën e të përditshmes. Të bëni disa ndryshime risie do t'ju bëjë gjithçka më të lehtë dhe të pëlqeshme. Nëse mundni largoni ata që ju duken shumë sipërfaqësorë dhe që ju i gjykonin jo shumë të besueshëm.

SHIGJETARI
Saturni ju jep shumë energji. Kjo është ideale për të dalë për t'u argëtuar me miqtë, por edhe për të ushtruar sporte të ndryshme. Do të dini, gjithashtu, edhe të gjeni një më të artë midis dashurisë dhe punës, duke fituar admirim nga të gjithë.

BRICJAPI
Nën mbikëqyrjen e Plutonit, ditën e sotme do të vihet në pah ana më kokëfortë e karakterit tuaj. Mbaje mend të rikthenen zënkta të vjetra familjare. Nxitimi mund të bëjë që të bëni gabime. Prandaj, përpara se të veproni, mendoni mirë atë që do të bëni.

UJORI
Me Mërkurin, Venusin, Marsin dhe Jupiterin bashkëpunëtorë, do të ndiheni shumë të sigurt në vetvete dhe të aftë për të pasur projekte largpamëse. Shijojeni këtë ditë të bukur dhe ndryshoni rutinën, duke përfutur këstu edhe gjatë javës.

PESHQIT
Të acaruar nga Neptuni në qiellin tuaj që grindet me Hënën, këtë ditë do të shfaqin anën më kryengritëse të karakterit tuaj. Nëse do të mendoni me qetësi do ta kuptoni se askush nuk po e kërcënon realitetin tuaj të dashurisë.



Më 14 nëntor duhet të gjejmë kundërshtar tjetër

Norvegjia preferon Sllovakinë para Shqipërisë, bie poshtë miqësorja

Ditën e djeshme u përfol se ishte zyrtarizuar edhe një ndeshje miqësore për muajin nëntor, ku më saktësisht në datën 14 të muajit tjetër, Shqipëria do të zhvillojë miqësoren me Norvegjinë. Por, nga ajo

çfarë shihet në faqen zyrtare të Federatës Norvegjeze të Futbollit, vihet re se federata e vendit nordik deklaroi se do të zhvillojë dy miqësore në nëntor, por asnjëra nuk programohet përballë Shqipërisë. Më saktë-

sisht, norvegjezët planifikojnë të luajnë ndaj Maqedonisë dhe Sllovakisë. Trajneri Lars Lagerbak deklaroi se është i kënaqur që do të zhvillojë dy miqësore ndaj Maqedonisë dhe Sllovakisë. Ai shprehet: "Jam i

kënaqur që do kemi dy miqësore në nëntor: Maqedonia dhe Sllovakia janë kundërshtarë të mirë. Të dyja ekipet janë zhvilluar kohët e fundit dhe kanë marrë rezultate pozitive. Çdo ndeshje na ndihmon të përmirësohemi" - përfundoi tekniku Lagerbak. Tashmë nuk dihet se cili do të jetë kundërshtari për miqësoren e programuar në muajin nëntor.

Në vitin 2004, Suedia dhe Danimarka eliminuan Italinë pasi e mbyllën ndeshjen me rezultatin 2-2

Italia për hakmarrje ndaj Suedisë në play-off

Ka një derbi ballkanas, Kroacia gjen Greqinë



Jeton Selimi

Në Zyrih është hedhur shorti për ndeshjet e play-offit, nga ku do të dalin katër skuadrat e tjera europiane, që do të shkojnë në Botëror. Shorti nuk ka qenë me fat për Italinë, që do të përballë me Suedinë, një kundërshtar nga më të fortët në short. Italianët preferonin një përballje me Greqinë, por kjo e fundit do të ndeshet me Kroacinë e trajnerit Zlatko Dalç në një derbi ballkanas. Duhet kujtuar play-off i fundit mes këtyre dy ekipeve në vitin 2011, që u ndez nga atmosfera e tifozëve në stadium. Irlanda e Veriut luan me Zvicrën dhe Danimarka me Irlandën. Ndeshjet luhen në nëntor, të parat më 9-11 nëntor dhe ato të kthimit më 12-14 nëntor.

"BISKOTA"

Të gjithë e kujtojnë ndeshjen e vitit 2004, në ka-



KUPA E BOTËS "RUSI 2018"
PLAY-OFF

Irlandë e Veriut - Zvicër
Kroaci - Greqi
Danimarkë - Irlandë
Suedi-Itali

mpionatin European, ku Italia u eliminua nga ky kom-peticion, pasi fati i saj

varej nga ndeshja Suedi-Danimarkë. Rezultati i vetëm që eliminonte italianët, ishte

ai 2-2, dhe pasi ndeshja përfundoi, kombëtarët "vikinge" e mbyllën ndeshjen po në re-

zultatit 2-2. Ky rast u cilësua si "biskota" për italianët, dhe përfundimisht ata

mbetën jashtë. Tashmë "axurrët" kanë rastin më të mirë për të kërkuar hakmarrjen ndaj suedezëve, në ndeshjen që do të luajnë për fazën "play-off", për të siguruar një biletë në Rusi 2018.

VENTURA

Në një intervistë pas shortit të hedhur për fazën "play-off", trajneri i kombëtares italiane, Khan Piero Ventura, u shpreh i bindur se Italia e tij do të presë biletën për në Rusi 2018. "Suedia meriton respektin maksimal, pasi është një kundërshtarë e fortë. Ka mundur Francën, dhe në renditje la pas Holandën. Ndeshjet e nëntorit do t'i përgatisim me shumë besim. Nuk e mendoj se nuk do të jemi pjesë e Botërorit. Bashkë edhe me dashurinë e tifozëve, do të shkojmë të gjithë për në Rusi" - deklaroi tekniku 69-vjeçar.

GABIMET E GJYQARËVE NDAJ KUQEZINJVE

Protesta e Flamurtarit, ndaj Kamzës ndeshja do nisë 15 minuta me vonësë

Flamurtari do të bëjë një protestë origjinale në sfidën e së dielës. "Panorama Sport" raporton se me mbështetjen e grupimit ultras të tifozëve, si dhe miratimit të administratorit të klubit, Sinan Idrizi, të dielën para ndeshjes Flamurtari-Kamza, do të zhvillohet një protestë prej 15 minutash për vendime që arbitrat kanë marrë në këto javë të para në dëm të kuqezinjve. Pritet që takimi i programuar për të dielën (22 tetor) në orën 17:00, të nisë të paktën me 15 minuta vonësë. Klubi është i bindur se "fushata" kundër Flamurtarit me gjyqtarët është tendencioze nga institucioni i futbollit shqiptar, nisur nga kritikrat që kanë ardhur vazhdimisht nga vetë administratori Idrizi për FSHF-në. Në lidhje me gabimet e arbitrave këto javë ndaj Flamurtarit, mesfushori i skuadrës vlonjate, Emiljano Musta, ka postuar në "Instagram", edhe një foto, duke ironizuar xhaketat e zeza për vendimet e tyre këtë sezon.



CHAMPIONS LEAGUE

Euseid Hysaj nuk ka ardhur ta mbyllë ndeshjen e sotme kundër Mançester Sityt, pasi është zëvendësuar në minutën e 70 të ndeshjes së tretë në fazën në grupe të Ligës së Kampioneve. Shkak për këtë është bërë një dëmtim që futbollisti ka marrë pas një përplasjeje të dhunshme kokë më kokë me spanjollin David Silva. Dy lojtarët janë përplasur pas një dueli ajror dhe kanë pësuar të çara në kokë. Ata kanë marrë mjekimin e menjëhershëm nga stafet



mjekësore të ekipeve, duke lënë fushën e lojës për disa minuta. Por edhe pse mbrojtësit shqiptar u vu në fashë nga mjekët, ai vazhdon të kishte hemorragji në të çarën që kishte marrë mbi vet-

Siti thyen Napolin, Hysaj lë fushën i gjakosur

ull. Ndaj trajneri Sarri vendosi që të mos e rrezikonte më shumë futbollistin e përfaqësues shqiptar dhe e largoi nga fusha e lojës, duke aktivizuar në vend të tij Kristian Maxhon.

REZULTATET


Liga e Kampioneve ka dhuruar sot emocione të shumta dhe një numër të madh golash, 31 të tillë në 8 ndeshjet, që kanë dhuruar mjaft rezultate të befasishme. Plotësisht i papritur ishte rezultati në Grupin E mes Spartakut të Moskës dhe Seviljes, ku skuadra ruse ka fituar me diferencë të thellë 5-1 përballë spanjollëve, të cilët në vitet e fundit kanë shfaqur një ekip

CHAMPIONS

SOT GRUPI E		
Maribor - Liverpool	X-X	
Spartak - Sevilja	X-X	
GRUPI F		
Fejrnord - Shakhtar	X-X	
Man.Siti - Napoli	X-X	
GRUPI G		
Monako - Beshiktash	X-X	
Lajpcing - Porto	X-X	
GRUPI H		
Nikosia - Borussia	X-X	
Real - Totenham	X-X	

shumë cilësor në arenën europiane. Me një goleadë të thellë ka fituar Liverpooli përballë Mariborit të Valon Ahmetit. Shifrat 7-0 barazojnë rekordin e fitores më të thellë jashtë fushe në këtë turne.

Fjalëkryqi (1)



- 46. Kufizojnë një send.
- 47. De Filippi e Amici.
- 49. Pagëzoi Shën Palin.
- 52. Ushtrohet një me tryzni.
- 54. Victorien dramaturg.
- 55. Eshhtë edhe ai i Zi.
- 56. Fillojnë tatëpjetën.

- VERTIKAL**
- 1. Hunt aktore.
 - 2. Nolde piktor.
 - 3. Gjysm w siklet.
 - 4. Marsi në Areopag.
 - 5. Janë antena satelitore.
 - 6. Rrithet në fund.
 - 7. Pak tebaizëm.
 - 8. Janë taksat.
 - 9. Një test.
 - 10. Ferrara regjisori.
 - 11. Eshhtë luftë.
 - 12. Kufizojnë citatet.

HORIZONTAL

- 1. Janë llogari.
- 8. Kufizojnë një trup.
- 10. Janë nocionet e para.
- 13. Janë vendet si Katar.
- 14. Shkruajnë nga e djathta në të majtë.
- 16. Një pije... dardhe.
- 17. Janë me marka në armatura.
- 19. Artikull spanjoll.
- 20. Një pjesë e sadistëve.
- 22. Janë sherma.
- 25. Mund të jenë informacioni.
- 27. Fillojnë javën.
- 28. Janë gratë në Marrakesh.
- 30. Janë dhoma.
- 32. Një Aridian guvernator i Bankës.
- 33. Demek s'ka kufij.
- 35. Janë centralet si Chernobyl.
- 38. Mbyllin një dyqan.
- 40. Një impiant hi-fi.
- 42. Rolet pa re.
- 44. Një pjesë e parlamentit.
- 15. Një lëndë e organizmit.
- 18. Quheshin edhe Eumenide.
- 21. Ai i bardhë është quajtur David Bowie.
- 23. Eshhtë si baba.
- 24. Julia i Familja Addmas.
- 26. Jules shkrimtar.
- 28. Mafia pa zë.
- 29. Role pa zë.
- 31. Eshhtë zbulurim në skenë.
- 33. Inicialet e Morricone-s.
- 34. Irene aktore.
- 36. Kufij në Oslo.
- 37. George shkrimtare.
- 39. U shkrua nga Emile Zola.
- 41. U shit për një pjatë thjerza.
- 43. Film shqiptar.
- 45. Me të nxjerrin trarë.
- 47. Bega komik.
- 48. Eshhtë yll i skuadrës.
- 50. Fillojnë ndeshjen.
- 51. Satelit i Uranit.
- 52. Inicialet e Dukas kompozitor.
- 53. Mbarojnë fare.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- 1. Ndan kapitujt
- 8. Emri i Gonçarov.
- 12. Eshhtë e hollë dhe therëse.
- 13. Inicialet e Stone regjisori.
- 14. Eshhtë edhe ajo mistrat.
- 15. Kryeqyteti i Marokut.
- 16. Ki Moon në OKB.
- 18. Eshhtë lloj papagalli.
- 19. Një pjesë e amerikanëve.
- 20. Gjysmë tandem.
- 21. Hapet me trapano.
- 23. Një sigël maunesh.
- 24. Ishte djali i Odiseut.
- 26. Eshhtë sherr në shtyp.
- 27. Artikull spanjoll.
- 29. Eshhtë zog i verdhë.
- 30. Mund të jetë kuzhine.
- 31. Inicialet e Lattuada regjisori.
- 33. Eshhtë shtet i papës.
- 35. Mbeten në fund.
- 36. Pesci aktor.

VERTIKAL


- 38. Unë dhe ti.
- 39. Jepet për hartim.
- 41. Kërket nga poeti.
- 43. Rastisin në krye.
- 44. Eshhtë edhe ai i Kuq.
- 46. I oha fillin Tezeut.
- 48. Në krye të armatës.
- 49. I vetmi në orar.
- 51. Eshhtë ai që premtom të bëhet as.
- 52. Leblanc që krijoi Arsene Lupin.

VERTIKAL


- 1. Një bukanier.
- 2. Mosketieri jezuit.
- 3. Janë zënë në lüstë të tillë.
- 4. Pak analogji.
- 5. Gishti pa shi.
- 6. Në radhë të parë.
- 7. Tiriac që qe tenist.
- 9. Tregohet nga busulla.
- 10. Kaçaturian kompozitor.
- 11. Fillojnë natën.
- 16. Vallëzon me tutu.
- 17. Janë ata që nuk kanë shumë gjak.
- 18. Mund të jenë kursimi.
- 20. Janë katër në violinë.
- 21. Janë vendet e pazëna.
- 22. Në mes të Edgar dhe Poe.
- 24. Janë ato që na përkasin.
- 25. Këngëtare italiane.
- 26. Një pjesë e pavjunit.
- 27. Braktisi Didoñën.
- 28. Mune të jenë lubrifikantë.
- 32. Lumë në Francë.
- 34. Kush është... do të pijë.
- 37. Nolde piktor.
- 40. Parashetë zvogëluese.
- 42. Zanore arabe.
- 43. Rastet pa set.
- 44. Pak dramatike.
- 45. Maket pa kufij.
- 47. Inicialet e Nolte aktor.
- 48. Inicialet e Moravia-s.
- 50. Kështu përfundin një polic.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	L	E	X	S	G	P	O	A	Z	I	
M	I	S	H	N	D	O	R	E	S	H	R
A	R	A	M	O	G	O	A	U	T	O	
M	K	I	M	N	O	V	A	K	O	N	
T	S	E	R	I	A	L	I	A	R	T	I
P	R	E	T	E	N	D	I	M	I	O	K
R	O	N	A	L	E	D	O	I	G	A	E
M	A	L	E	N	G	O	R	E	T		
B	A	T	A	R	I	A	T	E	R	O	R
T	R	O	N	Z	R	A	A	C	E	M	I
L	I	R	I	K	E	P	A	R	O	D	I
L	O	I	R	A	C	O	R	O	T	K	N

FJALËKRYQI (1)

F	A	L	L	K	E	S	D	O	R	A		
A	D	A	M	P	A	L	I	M	I	N		
L	E	M	T	A	B	E	L	A	T	I		
A	T	K	A	P	I	T	U	L	L	I	M	
N	M	A	R	I	N	A	R	I	L			
G	R	E	M	I	N	A	U	E	F	E		
A	R	I	F	D	E	N	T	I	S	T		
D	P	I	K	A	T	E	S	E	R	T	E	
G	T	I	A	T	E	M	E	T	E	O	R	E
O	S	Z	R	A	M	T	R	E	T			
S	H	I	T	E	P	I	T	E	L	E	J	A
A	E	K	A	M	I	N	I	S	A	R	I	

FJALËKRYQI (2)

SUDOK

7						5	2	
8	4			2		1		6
			7	1	9			
	8		2			9	6	5
		7	1		6	2		
2	3	6			8		4	
			6	3	1	4		
4		1		8			9	7
	5	2			7			8

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

3	2	5	8	9	1	7	4	6
7	4	1	6	5	2	9	3	8
6	9	8	7	4	3	5	1	2
8	6	7	4	3	9	1	2	5
2	5	9	1	6	7	3	8	4
1	3	4	5	2	8	6	7	9
4	1	2	9	7	5	8	6	3
5	7	3	2	8	6	4	9	1
9	8	6	3	1	4	2	5	7

Argëtim filozofik

- "Çfarëdo që ju jeni, të jeni i mirë." **Abraham Lincoln**
- "Pengesat janë ato gjëra të shëmtuara, që ju shihni kur i largoni sytë nga qëllimi juaj." **Ford Henry**
- "Imaginata është fillimi i krijimit. Ju imagjinoni atë që dëshironi dhe më në fund ju e krijoni atë." **George Bernard Shaw**

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

18	3		1	6	9	8	11	9	16	4	8	
18	5	16	4	12	7	3		2		1	14	
8	1	6	3	11	8	8	8	9	6	1		
3	R	9	5	2	7	3	12	8	9	13	12	
9	K	5	2	7	3	1	4	8	15	1	4	
9	6	8	12	8	9	7			6		10	
4	3	5	9	7	8	3	5	12	8	9	7	
3	16	1	6	4	7	15	8	4	1			
8	4	1	6	6	1	16	7		7	12	1	
13		6	7		11	1	7		4	1	18	
11	1	7		17	7	1	12		6	8	17	1
10	13	4	13	3	8	16	4	7	4		1	3

A	R	T	M	K	R	I	M	B	A	T
N	G	U	J	I	M	U	A	N	E	
I	B	A	N	I	M	K	H	M	E	R
J	H	K	A	N	I	B	A	L	E	T
E	B	O	T	E	R	O	R	E	T	
L	A	B	O	R	A	T	O	R	E	T
H	A	I	R	V	A	N	T	O	R	
R	E	N	E	A	N	T	R	E	H	
A	V	E	T	V	I	I	I	G	U	
K	A	N	T	M	E	K	T	I	N	
U	T	I	B	E	T	A	T	E	M	E
J	R	R	U	G	A	A	R	T	E	T

Thënie të mërcura

- Bota është plot dyer, plot raste, fije të tendosura që presin t'u biesh. **(Ralf Valdo Emerson)**
- Të jesh gjithmonë i ndershëm me veten, është një ushtrim i këndshëm. **(Sigmund Freud)**
- Jeta është si një libër, varet si e shkruan dhe me çfarë boje... Kurrë s'e bëj gabimin e të debatuarit me njerëz, për opinionet e të cilëve nuk kam respekt. **(Edward Gibbon)**
- Nuk është e bukur ajo që është e bukur, por e bukur është ajo që ju pëlqen. **Italiene**
- Fillimi i mirë - garanci e mbarimit të mirë. **Fishart**

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

